

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it




E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.3 - MARZO/MARS 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543



Ron Kubati shkrimtari migrues

Emri i tij, ndër shkrimtarët e Italisë është mishërimi i shkrimtarit migrues, që mendon shqip e shkruan italisht, flet për Italinë e Shqipërinë, për të kaluarën e të tashmen me atë gjuhë që po të uleshin e të shkruanin do të shpreheshin ndoshta të gjithë emigrantët e dyzuar shqiptarë në këtë anë të botës.



Racizmi është krim i dënueshëm

PADITENI

Atmosfera është gjithnjë e më e rëndë dhe jo vetëm për shkak të keqtrajtimeve, atentateve dhe dëbimit të të huajve. Vaska ku kjo barbari noton e rritet ushqehet përditë nga përgjithësimet, kafshëria dhe sharjet, të thëna shpesh nga ata që, si pjesë e klasës politike, duhet të mbajnë fort timonin e Italisë në rrugën e qytetërimit.



PADITJET NË SPITALE SHËNDETI NË RREZIK

Nëse edhe Dhoma e deputetëve miraton tekstin e projektligjit të miratuar tashmë në Senat, mjekët dhe infermierët janë të lirë të denoncojnë klandestinët që shkojnë për t'u kuruar, duke i hapur kështu rrugën dëbimit të tyre.



WESTERN UNION
MONEY TRANSFER

www.stranieriinitalia.it
il portale dell'immigrazione

Ministero per le Pari Opportunità
Ufficio Nazionale Antidiscriminazioni Razziali

Viktimë e racizmit?

Telefono falas NË NUMRIN E GJELBËR
800.90.10.10

PADISNI RACIZMIN (e na e bëni të ditur)

Atmosfera është gjithnjë e më e rëndë dhe jo vetëm për shkak të keqtrajtimit, atentateve dhe dëbimit të të huajve. Vaska ku kjo barbari noton e rritet ushqehet përditë nga përgjithësimet, kafshëria dhe sharjet, të thëna shpesh nga ata që, si pjesë e klasës politike, duhet të mbajnë fort timonin e Italisë në rrugën e qytetërimit.

Sa dallim ka mes kujt thotë që një popull i tërë është "i specializuar në përdhunime" dhe një tjetri që në vend të dhunës verbale parapëlqen dhunën fizike të linçimit? Sa deklarata mbi tolerancën zero tashmë kanë zhvlerësuar racizmin dhe përsëriten aq shpesh sa nuk skandalizojnë më asnjë?

Është koha që të ngrihet

zëri, duke paditur këdo që ushqen urrejtjen. Nuk është e vështirë. Ligji ndalon diskriminimin, godet fajtorët dhe mbron viktimat. Por, nëse i vetëm mund të të duket diçka e ndërlikuar, ke ku të kërkojsh ndihmë. Në Itali ekziston Zyra kombëtare kundër diskriminimit racial (UNAR) që parandalon, zbulon, lufton racizmin dhe mbron viktimat e tij.

Të kontaktosh UNAR-in është fare e thjeshtë, mjafton të telefonosh numrin e gjelbër shumëgjuhësh 800 90 10 10 (nga e hëna në të premte, nga ora 10.00 deri në orën 20.00) ose të nisësh një mesazh në postën elektronike me adresë antidiscriminazioni@pariopportunita.gov.it duke shpjeguar ç'të ka ndodhur. Për

UNAR, zyra kundër diskriminimit racial

U.N.A.R. (Zyra Kombëtare kundër Diskriminimeve Raciale), ka për detyrë kontrollin dhe garantimin e parimit të barazisë së trajtimit, për këdo që është viktimë e një diskriminimi apo shqetësimi të pësuar, për shkak të origjinës etnike apo raciale. Zyra e re është një pikë referimi për të gjithë ata që duan të jenë të mbrojtur në të drejtat e tyre, kundër çdo forme të diskriminimit racial.

Një numër pa pagesë kundër diskriminimit racial: 800.90.10.10

U.N.A.R. ka vënë në dispozicion edhe një numër pa pagesë 800.90.10.10, i cili është aktiv çdo ditë nga ora 10:00 deri në 20:00. Qendra me të cilën kontaktoni (Contact Center), është e gatshme t'ju përgjigjet në gjuhët italisht, anglisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht, rusisht, rumanisht dhe atë kineze mandarino dhe jep informacione, orienton dhe ofron mbështetje e ndihmë për viktimat e diskriminimeve raciale. Duke telefonuar në këtë numër, mund të denonconi apo të jepni dëshmi për fakte, ngjarje, procedura apo veprime që paragjykojnë, për shkak të racës apo origjinës etnike, barazinë e trajtimit mes personave të ndryshëm. Contact Center vepron aty ku është e mundur, për zgjidhjen e problemeve ose, përmes ekspertëve të zyrës, shoqëron personat e diskriminuar në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Impenjimi i UNAR

Në rast se mbërrin lajmi mbi akte apo sjellje diskriminuese, U.N.A.R. ofron ndihmë dhe mbështetje në proceset juridike apo administrative dhe mund të bëjë hetime në rrugë të pavarur me qëllim që të verifikojë ekzistencën e dukurive diskriminuese. Ndër të tjera, kjo zyrë zhvillon veprimtari pajtuese jozyrtare që ka për qëllim evitimin e rrugës gjyqësore në mënyrë që të arrijë zhdukjen sa më të shpejtë të çdo sjelljeje apo mekanizmi diskriminues.

Përveç këtyre, UNAR (Zyra Kombëtare kundër Diskriminimeve Raciale)

është e impenjuar edhe në veprimtari të mëposhtme:

Parandalim - U.N.A.R. i drejtohet opinionit publik përmes fushatave të sensibilizimit, të edukimit nëpër shkollë, dhe të informimit në vendet e punës. Objektiv i është ndalimi i lindjes dhe formimit të sjelljeve dhe akteve diskriminuese për të bërë të mundur që parimi i barazisë së trajtimit të bëhet një pasuri edukuese dhe kulturore e çdo personi.

Promovim - U.N.A.R. promovon projekte dhe veprime pozitive të drejtuara në eliminimin që në bazë të situatave të dizavantazhit për shkak të origjinës etnike apo raciale. Zyra i jep një rëndësi të veçantë realizimit të studimeve, kërkimeve, kurseve të formimit dhe shkëmbimit të eksperiencave për eliminimin e pengesave në përdorimin e të gjithë shërbimeve publike dhe private dhe mbi të gjitha në shërbimin e plotë dhe të ndërgjegjshëm të të drejtave qytetare e shoqërore.

Monitorim dhe verifikim - Zyra e U.N.A.R., për çdo vit harton një relacion për parlamentin mbi aplikimin efektiv të parimit të barazisë së trajtimit dhe mbi efikasitetin e mekanizmave të mbrojtjes, si dhe një relacion që i drejtohet Kryetarit të Këshillit të Ministrave mbi aktivitetin e zhvilluar, për t'u bërë të ditur organeve politike dhe opinionit publik, progresin dhe problemet që hasen gjatë punës për të luftuar diskriminimet raciale.

”

Me telefon apo e-mail është e lehtë t'i përcillni sinjalizimet tuaja UNAR-it, që nga anë e saj ka denoncuar disa politikanë. Na i dërgoni edhe neve në www.shqiptariitalise.com

të sinjalizuar një rast diskriminimi apo racizmi nuk nevojitet leja e qëndrimit. Dhe UNAR vihet menjëherë në lëvizje.

"Kemi shkallë të ndryshme ndërhyrjeje. Shpesh operatorët tanë arrijnë të zgjidhin problemin duke kontaktuar autorët e diskriminimit dhe duke i bindur ata të ndryshojnë sjelljen. Situata më të ndërlikuara u përcillen për shqyrtim një funksionari apo eksperti, si gjykatës, antropologë apo një figurë tjetër e përshtatshme për rastin" shpjegon Roberto Berardi, funksionar i UNAR-it.

Funksionarët dhe ekspertët përpiqen të gjejnë rrugën më efikase sipas rastit, për shembull, duke ndërhyrë drejtpërdrejt pranë administratës publike apo ndërmarrjeve që

Atmosfera është gjithnjë e më e rëndë dhe jo vetëm për shkak të keq-trajtimeve, atentateve dhe dëbimit të të huajve. Vaska ku kjo barbari noton e rritet ushqehet përditë nga përgjithësimet, kafshëria dhe sharjet, të thëna shpesh nga ata që, si pjesë e klasës politike, duhet të mbajnë fort timonin e Italisë në rrugën e qytetërimit.

Racizmi është krim i dënueshëm PADITENI!



po diskriminojnë, ose duke i thirrur palët për t'u dhënë mundësinë e një marrëveshjeje informate. "Por të gjithë atyre që duan të shkojnë në gjyq për të ngritur një kauzë civile kundër diskriminimit, UNAR-i u ofron mbështetje, edhe pse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. I drejtojmë viktimat te shoqata që mund t'i përfaqësojnë në gjykatë apo tek avokatë që mund t'u ofrojnë asistencë falas" shton Berardi.

Deri tani kemi folur për raste të veçuara. Si mund të veprohet me ata që nxisin urrejtjen kundër një grupimi të tërë etnik?

"Në raste të tilla vihemi në lëvizje edhe në mënyrë të pavarur, si zyrtarë shteti. Racizmi është krim, ndaj ne ia dërgojmë çdo lajm mbi këtë krim autoriteteve

gjyqësore kompetente" sqaron funksionari. Tashmë UNAR-i ka paditur disa politikanë për batutat e tyre të botuara në shtyp. Atëherë, përse të mos i jepet një dorë UNAR-it, duke i sinjalizuar të gjitha ato raste që bien erë racizëm? Nëse indinjoheni me dikë që predikon urrejtjen, nëse dëgjoni apo lexoni shprehje diskriminuese, nëse ju fyejnë vetëm pse jeni të huaj telefononi në 800 90 10 10 ose dërgoni një mail në antidiscriminazione@pariopportunita.gov.it. Nisni paditjen tuaj edhe në redaksia@botashqiptare.net, do të na ndihmojë të ndjekim rastet tuaja e t'u bëjmë të ditur të gjithëve sesi ndëshkohet racizmi në Itali.

Elvio Pasca



RACA E DHUNES

Më mirë të shkarkohen të gjitha fajet mbi rufepritësen "i huaji". Sa më shumë është fajtor "ai", aq më të pafajshëm jemi të gjithë ne italianët.

Ndihmësja shtëpiake është filipinase, shitësi i rrugës afrikan, luleshitësi pakistanez, tezgaxhiu kinez, përdhunuesi... rumun. Është psikoza e një epoke të sëmurë, kur dhuna më e urryer bëhet "etnike"; kur banda që shkatërron jetën e një vajze nuk gjykohet për atë çka ka bërë, por për vendin prej nga vjen.

Të dhënat tregojnë tjetër gjë. Portali internet voce.info nxjerr në dritë që prej vitit 1990 deri më 2003-shin numri i lejeve të qëndrimit është pesëfishuar ndërsa kriminaliteti ka rënë paksa; dhe shton që e njëjta gjë vlen edhe për pjesën "e fshehur", me një fjalë, edhe për të parregulltit dhe krimet e padenoncuar. Po sa vlerë kanë shifrat, kur një vend i tërë dëshiron të pastrojë ndërgjegjen?

Ne, turmë e egërsuar që dëshiron të harrojë. Ne nuk duam të shohim që specialistët e përdhunimeve, të droguar e të dehur, janë të rinj shpesh borgjezë e të kamur. E që në mëse tre të katërtat e rasteve të dhunës seksuale përdhunuesi ka "çelësat e shtëpisë". Dhe që qytetet tona duken sikur janë projektuar posaçërisht për të ngritur pusë, sepse janë të errëta e plot periferi të lëna në degradim, sepse në diskoteka droga qarkullon si të ishte ujë mineral, sepse në darkë metrotë mbyllin dhe autobusët bëhen gjithnjë e më të rrallë, sepse festat e të rinjve janë kthyer në territore të pakontrollueshme ku gjithçka mund të ndodhë.

Ne nuk mund ta shohim këtë realitet sepse vë në dyshim bindje të patundshme: familja e shenjtë e mbrojtëse, bijtë tanë vajza e djem të mbarë. Ndaj është shumë më e lehtë t'u hedhim fajet rufepritëses "i huaji". Sa më shumë është fajtor "ai", aq më të pafajshëm jemi të gjithë ne italianët.

Mbeten shumë pikëpyetje pezull, të shpërfillura. Që ligji ynë konsideron rrethanë lehtësuese kryerjen e krimeve nën efektin e drogës, mos është faji i rumunëve? Që gjykatësve tanë u duket

Normalë të lënë në shtëpi dikë që sapo ka përdhunuar një grua, mos është faji i rumunëve? A mos është faji i rumunëve edhe që një mama nga Nettuno thotë që i biri gjashtëmbëdhjetë vjeçar fajtor

RACA E DHUNËS

vijon nga faqja 3

për vënien e zjarrit një të pas-trehu është djalë me zemër të mirë, i marrë më qafë nga më të mëdhenjtë?

Asnjë nuk rrethon makinën e policisë, asnjë nuk ka etje për linçim kur arresti shtëpiak i jepet një "djali të mbarë" italian që ka përdhunuar për bast, që i ka vënë flakën një njeriu për të lozur. Asnjë nuk i kërkon llogari klasës politike për një ligj sipas të cilit përdhunimi vlen më pak se tre vjet burg, pra kush e kryen merr lirinë me kusht; e për një tjetër ligj që bën të pamundur paraburgimin kur krimi për të cilin akuzohet i pandehuri parashikon lirinë me kusht.

Asnjë nuk i kërkon llogari drejtësisë italiane për sytë e mbyllur para dhunës së ushtruar mbi gratë islamike, nga burra që praktikojnë në Itali shariah-n më të egër që nuk mund ta praktikojnë as në vendet prej nga vijnë. E asnjë nuk guxon të fusë hundët në familje, ku dhuna është më e pakapshme dhe më tragjike, sepse në këtë rast dikush abuzon me një person që i ka dhuruar besimin dhe jetën e vet, sepse shpesh dhuna e abuzimi bëhen mbi të mitur, sepse jo rrallëherë gruas ia mbyllin gojën ndjenjat si frika, turpi, ndjenja e fajit që i shtohet sfillitjes së trupit.

"U shpjegoni fëmijëve se ç'pasoja të rënda mund të kenë veprime të caktuara", thotë Giovanni Bollea. Por, para së gjithash, u duhet shpjeguar nënave e baballarëve. Edhe që "veprime të caktuara" nuk kanë as ngjyrë e as racë.

Sergio Talamo

PADITJET NË SPITALE SHËNDETI NË RREZIK



Spitalet rrezikojnë të kthehen në fusha të minuara për ata që ndodhen në Itali pa dokumentin e qëndrimit. Nëse edhe Dhoma e deputetëve miraton tekstin e projektligjit të miratuar tashmë në Senat, mjekët dhe infermierët janë të lirë të denoncojnë klandestinët që shkojnë për t'u kuruar, duke i hapur kështu rrugën dëbimit të tyre.

Spitalet rrezikojnë të kthehen në fusha të minuara për ata që ndodhen në Itali pa dokumentin e qëndrimit. Nëse edhe Dhoma e deputetëve miraton tekstin e projektligjit të miratuar tashmë në Senat, mjekët dhe infermierët janë të lirë të denoncojnë klandestinët që shkojnë për t'u kuruar, duke i hapur kështu rrugën dëbimit të tyre. Sot, Teksti Unik mbi imigracionin parashikon që "përfitimi i shërbimeve pranë strukturave shëndetësore edhe nga të huajt pa qëndrim të rregullt në Itali nuk sjell si pasojë sinjalizimin e tyre te organet e policisë". Projektligji i ri përpiket të zhdukë këtë normë, falë një propozimi të Legës të miratuar në Senat me votat e qendrës së djathtë.

Le të imagjinojmë një të huaj klandestin të sëmurë. Kur do të vendosë të shkojë në spital

Projekt ligji i qeverisë kërkon që të mund të sinjalizohen forcat e rendit për klandestinët që u drejtohen strukturave shëndetësore. Ende nuk është kthyer në ligj; kush nuk ndihet mirë, të shkojë te mjeku

duke e ditur që kjo gjë mund t'i kushtojë dëbimin nga Italia? Ndoshta kur të jetë shumë vonë. E ndërkohë, nëse ka një sëmundje ngjitëse, sa persona të tjerë rreth tij mund të infekttojë? Frika e paditjes do të majë larg spitaleve edhe gra shtatzëna, që do të rrezikojnë kështu, të përfundojnë në qarqet "paralele" që, padyshim, nuk mund t'u ofrojnë të njëjtën siguri e profesionalizëm të strukturave publike.

Këto probleme shqetësojnë edhe të gjithë urdhrat profesionalë që punojnë në spitale (mjekë, infermierë, mami dhe asistentë socialë), që, me sloganin "jemi mjekë, jo spiunë" i bëjnë thirrje klasës politike të mos ndryshojë normat në fuqi. "Një nga parimet themelore që kanë të bëjnë me shëndetin si një e mirë kolektive bazohet në përfitimin e lirë prej të gjithëve të kurave mjekësore, ndaj çdo masë që mund të kufizojë këtë liri rrezikon të kthehet në një bumerang për mbrojtjen e shëndetit të të gjithëve" thotë Amedeo Bianco, kryetar i Federatës kombëtare të urdhrave të mjekëve kirurgj dhe dentistë (Fnomceo).

"Ashtu si në luftë, edhe në atë më të përgjakshmen - reflekton Bianco - dy grosh arsye mundësojnë hapjen e të ashtuquajturave "korridore humanitare" përmes të cilave bëhet i mundur ushtrimi i solidaritetit dhe i përkrahjes me më të dobët, në të njëjtën mënyrë mendojmë që në një komunitet modern e të

vijon në faqen 6

BOTIM I / EDITORE Edizioni Botta shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE Ë ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keti Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

shqiptari i italisë

l'italiane d'italia

e përmuajshme suplement i

Bota shqiptare

gazeta e shqiptarëve në itali

ISTITUTO LUCE
PRESENTA



ALBANIA

IL PAESE DI FRONTE

REGIA
ROLAND SEJKO
MAURO BRESCIA



LUCE

**IL PRIMO DOCUMENTARIO
SULLA STORIA DELL'ALBANIA**



REGIONE LAZIO

N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E

PADITJET NË SPITALE SHËNDETI NË RREZIK

vijon nga faqja 4

qytetëruar (për më tepër në paqe) strukturat që ofrojnë kura mjekësore duhet të mbeten gjithnjë një zonë ku çdokush të ndihet i mbrojtur nga solidariteti dhe humanizmi".

Urdhri i Mjekëve ka hedhur edhe një hap më shumë, duke lajmëruar që, nëse norma e re do të hyjë në fuqi, do të marrë masa kundër të gjithë atyre mjekëve që do të denoncojnë emigrantët e parregullt. Sipas Urdhrit të Mjekëve, denoncimi shkel kodin deontologjik dhe betimin e Hipokratit.

Me një fjalë, vështirë që

**DIVIETO DI SEGNALIZIONE
SIAMO MEDICI E INFERMIERI
NON SIAMO SPIE**

mjekët, edhe sikur ligji të hyjë në fuqi, të denoncojnë pacientët e tyre. Po sa emigrantë do të jenë të gatshëm ta vërtetojnë këtë gjë mbi kurrizin e tyre?

Ndërkaq një gjë është e sigurt. Mjaftoi lajmi që po miratohet një ligj i tillë për t'i mbajtur klandestinët larg spitaleve: një hulumtim i agjencisë së lajmeve Adnkronos në dhjetë struktura të Romës e Milanos ka nxjerrë në pah që gjatë ditëve menjëherë pas miratimit të tekstit në Senat, shtrimet në spitale ranë me 15%. Por sidoqoftë, tani për tani nuk ka asnjë kuptim të bihet pre e frikës, sepse ligji që u ndalon mjekëve të denoncojnë është ende në fuqi. Edhe kush nuk ka lejen e qëndrimit, nëse nuk ndihet mirë të shkojë të vizitohet, askush nuk do ta denoncojë.

Elvio Pasca



Nëse keni ndonjë euro në xhep e një makinë të vjetër të parkuar në derë të shtëpisë, ndoshta ka ardhur momenti ta ndërroni.

Qeveria ka miratuar një paketë nxitjesh financiare (inventivi) për të ndërruar makinat që ndotin më shumë ambientin dhe për t'i dhënë një dorë sektorit automobilistik, i cili me krizën ekonomike dhe rënien e blerjeve rrezikon të nxjerrë në papunësi me mijëra persona. Paketa e nxitjeve financiare do të bëjë të mundur kursimin në blerjen e veturave, kamionëve dhe motoçikletave të blera brenda fundit të këtij viti dhe të regjistruara (immatricolate) deri më 19 mars 2010.

Kush heq nga qarkullimi një makinë Euro 0, 1 ose 2, të regjistruar deri më 31 dhjetor 1999 për të blerë një tjetër Euro 4 ose 5, me lëshim të ulët të anhidritit të karbonit fiton të drejtën e një zbritjeje çmimi prej 1.500 eurosh. E njëjta zbritje parashikohet edhe për këmbë një makinë me metan, elektrike apo me hidrogjen me lëshim CO2 jo më të lartë se 120g/km, edhe në rast se nuk heq nga qarkullimi një makinë tjetër.

Këto dy zbritje mund të mblidhen, ndaj kush heq nga qarkullimi një makinë ndotëse për të blerë një elektrike, me metan apo me hidrogjen, mund të kursejë

NXITJET FINANCIARE PËR BLERJEN MAKINAVE

JASIFUNKSIONOJNE

Kriza ekonomike e shtyn qeverinë të japë bonuse për blerjen e makinave të reja. Nëse keni një makinë të vjetër e po mendonit ta ndërroni, tashmë ka ardhur momenti i duhur për ta ndërruar. Mund të përfitoni me mijëra euro në zbritje çmimi

plot 3.000 euro.

Do të harxhohë më pak edhe kush vendos të mbajë makinën që ka por dëshiron ta bëjë më pak ndotëse. Në fakt parashikohet një zbritje prej 500 eurosh për instalimin e impiantit GPL dhe prej 650 eurosh për impiantin me metan.

Nga paketa e nxitjeve financiare nuk përjashtohen as të pasionuarit e dy rro-

tave. Ata kanë të drejtën e një kontributi prej 500 eurosh për blerjen e një motoçiklete me vëllim të cilindrit deri në 400 cm³ të kategorisë Euro 3, por vetëm nëse heqin nga qarkullimi një motoçikletë të kategorisë Euro 0 ose 1.

Nxitjet financiare janë edhe më të majme për automjete pune. Një kontribut prej 2.500 eurosh u jepet të

”

Nuk do të ketë ndonjë gjë të re as për dy muajt e ardhshëm sepse "marrëveshje të tilla hyjnë në fuqi dy muaj pasi në ministrinë e Transportit vjen njoftimi zyrtar i marrëveshjes nga ministra e Jashtme", dhe ky njoftim ende nuk ka mbërritur



Në mbyllje të këtij numri të gazetës, më 27 shkurt, kontaktuam sërish zyrën e Motorizimit të Ministrisë së Transportit për të marrë informacion lidhur me hyrjen në fuqi të marrëveshjes dypalëshe për njohjen dhe konvertimin e patentave shqiptare. Akoma asgjë, shqiptarët që duan të ngasin makinën janë të detyruar të japin provimin për të marrë patentën italiane.

Sipas sqarimit që nëpunësja e zyrës së Motorizimit civil dha për Shqiptarin e Italisë, nuk do të ketë ndonjë gjë të re as për dy muajt e ardhshëm sepse "marrëveshje të tilla hyjnë në fuqi dy muaj pasi në ministrinë e



gjithë atyre që heqin nga qarkullimi automjete për transport të përzier (njerëz dhe mallra), kamionë të lehtë brenda 3,5 tonelata, automjete për transporte të specifikuar, automjete për përdorim special dhe autorulota të kategorisë Euro 0, 1 ose 2 të regjistruara deri më 31 dhjetor 1999 dhe blejnë një automjet të ri Euro 4 ose 5.

Ndërsa një kontribut prej 4.000 eurosh, pa heqje nga qarkullimi të një makine ndotëse, u jepet atyre që blejnë automjete tregtare të lehta deri në 3,5 tonelata me metan. Edhe në këtë rast, nxitjet financiare mund të mbledhen: do të kursejnë 6.500 euro ata që do të heqin nga qarkullimi një automjet tregtar ndotës dhe do të blejnë një me metan.

PATENTAT SHQIPTARE ende nuk njihen në Itali

Transportit vjen njoftimi zyrtar i marrëveshjes nga ministria e Jashtme", dhe ky njoftim ende nuk ka mbërritur. Marrëveshja mes dy shteteve për njohjen reciproke dhe konvertimin e patentave për dhënien e makinës, është nënshkruar nga ministri i jashtëm Italian Franco Frattini, në kuadrin e bashkëpunimit në sektorin e transporteve të nisur nga qeveritë e të dy vendeve, në prani të kryeministrit shqiptar Sali Berisha, dhe ministrit të jashtëm Lulzim Basha. Por deri më sot, për emigrantët shqiptarë në Itali nuk ka ndryshuar asgjë. Me pak fjalë, që kartat e firmo-

sura në Tiranë nga ministri i Jashtëm Frattini, të kenë vërtet vlerë, të aplikohen, duhet më parë që të dyja vendet, Italia dhe Shqipëria, të ratifikojnë çka kanë nënshkruar. Porsa i përket më pas zbatimit në Itali të marrëveshjes, vetëm pas ratifikimit, ministria e Jashtme italiane i përcjell ministrisë kompetente, në këtë rast ministrisë së Infrastrukturave dhe Transporteve, tekstin e plotë të marrëveshjes. Së fundi, dy muaj pasi i njoftohet zyrtarisht ministrisë së Infrastrukturave dhe Transporteve, marrëveshja hyn në fuqi.

shqiptari
italise.com
portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

SA EURO ËSHTË MAKINA IME?

Siglat Euro 0, 1, 2, 3, 4 dhe 5 tregojnë sa ndotës është një automjet: sa më e re është makina aq më e lartë është shifra që pason 'Euro', dhe sa më e lartë është shifra aq më pak ndot automjeti. Shpesh nuk është e lehtë kuptosh se ç'sigël ka makina që nget, në librezën e qarkullimit të saj nuk gjendet e shkruar. Praktikisht deduktohet nga të tjera sigla të librezës, si më poshtë:

Euro 0 janë të gjitha automjetet (pa katalizator) të regjistruar deri në 31/12/1992, e me përjashtim të rasteve të veçanta, këto automjete nuk mund të qarkullojnë rrugëve të Italisë.


Euro 1 janë automjete të regjistruara nga data 01/01/1993 e këtej. Makina juaj është një Euro 1 nëse në librezën e qarkullimit të saj gjeni një prej këtyre siglave: 91/441/CEE, 91/542/CEE-A, 93/59/CEE.

Euro 2 janë automjete të regjistruara nga 01/01/1997 dhe që në librezën e qarkullimit kanë një nga këto sigla: 91/542/CE-B, 94/12/CEE, 96/1/CEE, 96/44/CEE, 96/69/CE, 98/77/CE.

Euro 3 janë automjete të regjistruara pas datës 01/01/2001. E juaja është Euro 3 vetëm nëse në librezë gjeni një prej siglave: 98/69/CE, 98/77/CE-A, 1999/96/CE, 1999/102/CE-A, 2001/1/CE-A, 2001/27/CE, 2001/100/CE-A, 2002/80/CE-A, 2003/76/CE-A.

Euro 4 janë automjete të regjistruara pas datës 01/01/2006. Në librezën e tyre të qarkullimit gjendet një prej këtyre siglave: 98/69/CE-B, 98/77/CE-B, 1999/96/CE-B, 1999/102/CE-B, 2001/1/CE-B, 2001/27/CE-B, 2001/100/CE-B, 2002/80/CE-B, 2003/76/CE-B.

Ndërsa Euro 5 janë automjetet më të reja, me datë regjistrimi të vitit në vijim (nga 01/01/2009). Në librezën e Euro 5-ës gjeni një prej këtyre siglave: 99/96 fase III, 2001/27 CE Rif, 1999/96 Riga B2 ose riga C, 2005/78 CE Rif 2005/55 CE Riga B2 ose riga C.



RON KUBATI

shkrimtari migrues

Të thuash Ron Kubati, ndër shkrimtarët e Italisë është si të thuash shkrimtar migrues, që mendon shqip e shkruan italisht, flet për Italinë e Shqipërinë, për të kaluarën e të tashmen me atë gjuhë që po të ulëshin e të shkruanin do të shpreheshin ndoshta të gjithë emigrantët e dëzuar shqiptarë në këtë anë të botës. Kubati është ndër emrat e parë që i mbërritur në Itali si emigrant, dhe diçka më shumë se kaq, përtej të zhvendosurit për arsye ekonomike, siç ndodh rëndom të kuptohet kjo fjalë, duke adoptuar kulturën, duke e ngjizur me të vetën, e duke përkthyer të gjithë këtë kon-

glomerat gjërash në gjuhën e re, të vendit adoptues. Kjo ndodhi si një mekanizëm për të komunikuar me ambientin e ri, një përlllogaritje instiktive prej shkrimtari që para se të prodhojë vepra përfytyron marrësin e tyre, dhe kushtëzon më tej kodin, për të përcjellë më mirë mesazhin. Pak i njohur në shqip, aq sa mund të lejonte mosha fare e re në të cilën la Shqipërinë në vitet '90, letërsia e Kubatit, tërësisht autobiografike, dhe si e tillë e pasur me histori interesante, që përcjellin shumë, ka lindur italisht dhe siç ndodh rëndom me këta lloj shkrimtarësh njihet më shumë jashtë Shqipërisë se sa brenda saj. Kjo jo detyrimisht për faj të arrogancës tiranase, apo provincializmit që në përgjithësi mbajnë të kopsitur tradicionalist institucionet

Të thuash Ron Kubati, ndër shkrimtarët e Italisë është si të thuash shkrimtar migrues, që mendon shqip e shkruan italisht, flet për Italinë e Shqipërinë, për të kaluarën e të tashmen me atë gjuhë që po të ulëshin e të shkruanin do të shpreheshin ndoshta të gjithë emigrantët e dëzuar shqiptarë në këtë anë të botës.

artistike shqiptare, por sepse kjo lloj letërsie ka të bëjë me Shqipërinë në mënyrë tangjente, edhe pse në to flitet shumë edhe për Shqipërinë. Por flitet për një Shqipëri të autorit, të përkthyer për një marrës që detyrimisht autori e njeh më mirë se ç'mund të njohë marrësin e tanishëm të Tiranës.

Kubati mbërriti në Itali, me një nga anijet e para, duke u personifikuar plotësisht me stereotipin e Shqiptarit të zbarkuar nga deti me ato lloj amebash kërcitëse, siç e përfytyronin në përgjithësi përkufizimin e të qenit shqiptar njeriu i mesëm italian. Dhe natyrisht i takoi të jetonte e të përjetonte po atë itinerar përballjesh me realitetin e ri që pësoi në Itali fenomeni i të qenit shqiptar në përgjithësi. Ndoshta edhe më

vijon në faqen 10



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizimi falas për të gjithë klientët e rinj deri më 8 mars 2009

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND


RON KUBATI Shkrimtari migrues

vijon nga faqja 8

ashpër duke qenë, se toka adoptuese në rastin e Kubatit, qenë brigjet puljeze që e thënë poetikisht e panë të zbarkonte dhe e strehuan midis tyre, me bujarinë, provincializmin, hapjen mendore, e tradicionalizmin që ka lidhur gjithmonë këto brigje të Adriatikut me ato përballë nga lindja. Ndërsa tani shkrimtari sa italian edhe shqiptar endet në të tjera brigje, shumë më të largëta, që është vështirë të përkufizohen në kaq pak kohë, në Çikagon e përtej Atlantikut. Ndoshta në të ardhmen do ta dëgjojmë këtë emër të flasë në të tjera gjuhë, në të tjera përmasa kozmopolitizmi apo fenomenesh migruese ndërkontinentale.

Letërsia e Kubatit buron nga jeta e jetueshme përditshme, dhe prandaj është e lexueshme, e rrjedhshme dhe identifikuese. Janë të shumta spuntot që ajo jep për të sqaruar një sërë fenomenesh që shumëkënd e prekin nga afër në brezin e tij. Libri i parë "Va e non torna", që ndjell pa dashur një lloj fatalizmi ballkanik, trajton atë gjendje të çuditshme që ishte largimi nga Shqipëria, limbi midis kësaj dhe asaj, dhe kërkimi që do të mbetet emblema e letërsisë së autorit, të përndryshes dhe tjetërkundit. Një parim ky që pllakosi breza të tërë shqiptarësh gjatë viteve '90. Pastaj vjen Italia në librat e tjerë *Il buio del Mare*, dhe *M*, përditshmëria prej të riu që jeton në Itali, midis komunitetesh alternative, komunitetesh të përkatësisë, dhe të kaluarës.

Me këtë dyzim që përshkon ekzistencialisht, shkrimin dhe gjuhën e Kubatit, të qenit migrues, në kuptimin më pozitiv të shprehjes është më e pakta që mund të thuhet. Ndërsa gjithmonë e më shumë letërsia migruese po strehohet në analet e letërsisë italiane për tu shndërruar në diçka autentike, pasuruese, dhe origjinale. Edhe letërsia e Kubatit ecën kësaj rrjedhe të dyfishtë. **ma.ru.**



”

Me këtë dyzim që përshkon ekzistencialisht, shkrimin dhe gjuhën e Kubatit, të qenit migrues, në kuptimin më pozitiv të shprehjes është më e pakta që mund të thuhet.

INTERVISTA

Ju jeni ndër të parët shqiptarë që kanë filluar të shkruajnë italisht, si ka ardhur kjo?

Kjo ka ardhur në mënyrë shumë natyrale. Unë kam filluar të shkruaj që shumë i ri. Që në kohën e gjimnazit, botoja në gazetën Drita. Kisha shkruar edhe disa tregime por që nuk arrita t'i botoja në atë kohë. Ndërsa vitet e universitetit ishin vitet e trazirave dhe unë mora pjesë si në lëvizjen e dhjetori ashtu edhe në të shkurtit dhe pastaj u largova nga Shqipëria në mars të '91. Fillimisht shkruaja poezi, me vone edhe tregime të shkurtra. Kur u largova për në Itali vazhdova të bëj letërsi. Në atë anë të Adriatikut si shumë shqiptarë u gjenda përpara mosnjohjes së thellë të Shqipërisë nga ana e italianëve. Është absurde ta mendosh, një vend vetëm pak kilometra larg për të cilin nuk dihej pothuaj asgjë. Perceptoja nevojën për të shpjeguar kontekstin e ri ku jetoja, dhe ku jetonim. Vazhdoja të shkruaja poezi, dhe në atë periudhë filloi të më ndodhte diçka e çuditshme. Vargjet filluan të më dilnin disa shqip e disa italisht. Nevoja për të shkruar në një gjuhë tjetër lind kur zëri i brendshëm ndryshon gjuhë. Kjo ndodh kur vëllimi i shkëmbimeve në gjuhën e dytë dominon gjatë dhe në mënyrë absolute kohën tende, ditët, studimin, punën, miqësitë, marrëdhëniet.

Ky fenomen është i natyreshëm.

Nuk bëhet fjalë për ndonjë sforcim, apo për diçka të stisur e të paramenduar. Bëhet fjalë për diçka që vjen nga brenda dhe nuk është një proces i thjeshtë. Të shkruarit në një gjuhë të dytë implikon shumë gjëra të reja. Mund të ndodhë që të shkruarit të mos jetë i zhdërvjellët fillimisht. Por edhe kjo kthehet në një gjendje ekzistenciale. Kthehet në një perspektivë të veçantë. Një identitet i ri, i brishtë i shtohet dhe përzihet me identitetin e mëparshëm. Fillon kështu një proces ndryshimi që, nëpërmjet disa fazave, nga njëra anë kërkon të zbusë dhimbjen e largimit dhe të zbeh aspektet me të vështira të së shkuarës, nga ana tjetër mundohet të minimizojë në mënyra të ndryshme distancat nga konteksti i ri. Rezultati optimal pas një periudhe të gjatë qëndrimi në një vend tjetër është biliguizmi (dygjuhesia) dhe përkatësia plurale. Ndërsa



reziku është një lloj alienacioni (tjetërsimi) si ndaj kontekstit të parë, po ashtu edhe ndaj kontekstit të dytë. Reziku është mospërkatësia (la non appartenenza), është natyrale që emigranti të kërkojë të realizojë rezultatin optimal.

Natyrisht kjo forcon lidhjet midis vendeve të ndryshme.

Mendoj që përkatësia plurale dominon eksperiencat e emigranteve, por një dozë e vogël mospërkatësie mbijeton. Ajo mund të krijojë ankthe në momente të vështira por njëkohësisht ushqen një vështrim të ri. Emigrantët kanë mundësinë që

Mund të ndodhë që të shkruarit të mos jetë i zhdërvjellët fillimisht. Por edhe kjo kthehet në një gjendje ekzistenciale. Kthehet në një perspektivë të veçantë. Një identitet i ri, i brishtë i shtohet dhe përzihet me identitetin e mëparshëm. Fillon kështu një proces ndryshimi që, nëpërmjet disa fazave, nga njëra anë kërkon të zbusë dhimbjen e largimit dhe të zbeh aspektet me të vështira të së shkuarës, nga ana tjetër mundohet të minimizojë në mënyra të ndryshme distancat nga konteksti i ri.

të shohin të gjitha kontekstet të paktën me një masë të vogël perjashtësie (esteriorita'). Kjo dozë perjashtësie është një privilegj i vyer për çdo lloj perspektive.

Ndoshta është edhe një mënyrë për të eksternalizuar diçka që përndryshe do të ishte e vështirë.

Kjo është një analizë interesante për të cilën kam medituar edhe unë. Por e rëndësishme është që autorët të mos përipiqen të analizojnë që në fillim këto aspekte por thjeshtë të shkruajnë. Nuk duhen krijuar

skema teorike, apo sovrastrukturë teorike në strategjitë të paramenduara, duhet ndjekur një fluks i brendshëm i të shkruarit pa menduar e pa stërholluar psetë. Ndoshta ky lloj të shkruarit më të mundshëm të arrij distancën e nevojshme për të shkruar gjëra me peshe emocionale ë veçantë. Nuk është e lehtë të ballafaqohesh me diktaturën, sic nuk është aspak e lehtë të tregosh traumën që emigracioni solli në shoqëritë tona. Mjafton të përmendet fakti që pamë shtresën e mesme të shoqërisë sonë të mos ishte më aspak e tillë jashtë

vijon në faqen 12



Specialisti për fluturime charter, low cost, fluturime linje dhe tragete

- Tiranë
- Durrës
- Vlorë

Bonus për ulje çmimi prej 20 eurosh, nëse na telefonon e thua "Offerta giornale"!!!

Prenotime Fluturim, Hotel, Makina me qira, Tragete dhe Trena në Shqipëri edhe me telefon, me çmime konkurruese.

TURISADRIA VIAGGI
VIA MAZZINI 119/C 47042 CESENATICO (FC)
Tel. 0547.82492– 0547.674221 - 340.7089484
www.volialbania.it

vijon nga faqja 11

Shqipërisë. Pamë se si mjekët tanë në më të mirën e rasteve u shndërruan në infermierë, ose përfunduan edhe më keq, të shkarkonin bagazhe në stacionet e trenave, inxhinierët u bënë elektrikistë, agronomët u bënë bujq e mësueset u bënë badante. Ky është një shok shumë i madh për një shoqëri. Vitet '90 ishin dramatike. Unë kam filluar të shkruaja kur kisha disa vjet që jetoja në Itali, e njihja gjuhën por jo akoma në mënyrë të përsosur. Ndoshta ishte mënyra më e mirë për të shprehur temat për të cilat doja të shkruaja.

Në këtë fazë të shkrimtarisë suaj e cilësoni veten si shkrimtarë migrues? Si ju duket ky epitet?

Kur shkrova romanin tim të parën nuk mendoja aspak për konceptin e letërsisë migruese. Nuk e imagjinoja se do të kategorizohesha kështu. Unë mendoj se kur shkruan nuk duhet të mendohet për atë që do të thonë më pas kritika apo gazetarët, thjesht duhet ndjekur rrjedha e të shkruarit. Nuk është një fenomen i thjeshtë i parë tani pas gjithë eksperiencës që kam krijuar. Sot e kuptoj të qenët tim si shkrimtar dhe nevojën e kritikës për të më klasifikuar si shkrimtar në ndonjë kategori. Kjo mund të jetë një zgjedhje që na pëlqen apo nuk na pëlqen. Nga pikëpamja e sociologjisë letrare vërehet prirja për të krijuar paradigma, që janë kategori të përkohshme që i shërbejnë kontekstit për të analizuar një fenomen të ri. Ata që propozuan në Itali këtë kategori patën parasysh kozmopolitizmin, duke iu referuar fenomenit migrant ëriters, në të cilin sot ka emra që vërtetë po dominojnë letërsinë botërore bashkëkohore. Klasifikimi në këtë kategori është një nder shumë i madh që mund të na bëjë. Problemi është perceptimi i kësaj kategorie nga opinioni dhe mënyra se si përcillet kjo kategori nga ana e mediave. Në rastin tonë kjo kategori u shndërrua në një dukuri të brendshme të fenomenit të migracionit, në një letërsi e prodhuar nga emigrantët që po shkruanin kështu dëshmitë e tyre të një jete prej migruesi: situata e tyre e vështirë, emargjimi, vuajtjet, nostalgjitë etj. Vënia e shenjës së barazisë midis shkrimeve të shkrimtarëve që shkruajnë në gjuhë të dytë dhe tematikave që përmenda ndikon natyrisht që të krijohet

RON KUBATI Shkrimtari migrues





RON KUBATI
IL BUIO DEL MARE
Giunti, 2007
120 faqe, € 12
ISBN: 8809054946

12 FINALISTËT E ÇMIMIT STREGA 2008, FITUAR NGA PAOLO GIORDANO ME "LA SOLITUDINE DEI NUMERI PRIMI"

Si çdo vit, 12 finalistët e përzgjedhur përmbledhinin përvojën dhe risinë në letërsinë italiane. Janë Ruggero Cappuccio me librin "La notte dei due silenzi" (Sellerio), Cristina Comencini, "L'illusione del bene" (Feltrinelli), Carlo D'Amicis, "La guerra dei cafoni" (Minimum fax), Giuseppina De Rienzo, "Vico del fico al Purgatorio" (Manni), Diego De Silva, "Non avevo capito niente" (Einaudi), Paolo Giordano, "La solitudine dei numeri primi" (Mondadori), Ron Kubati, "Il buio del mare" (Giunti), Giuseppe Manfridi, "La cuspidi di ghiaccio" (Gremese), Cristina Masciola, "Razza bastarda" (Fanucci), Emiliano Poddi, "Tre volte invano" (Instar Libri), Lidia Ravera, "Le seduzioni dell'inverno" (Notetempo) dhe Ermanno Rea, "Napoli Ferrovia" (Rizzoli).

Me librin e tij të fundit *Il buio del Mare* Ron Kubati hyri në duzinën e kandidatëve të përzgjedhur për çmimin letrar italian, *il Strega*. Që prej vitit 1947 Çmimi Strega, i cili mban emrin e pijes së njohur, *Liquore Strega*, sponsor i gjithëhershëm, është çmimi më i rëndësishëm letrar italian. Kandidatët e çmimit Strega përzgjidhen prej një jurie të përbërë nga 400 kritikë e lexues të cilët në fund zgjedhin edhe fituesin. Në mëse 50 vjet të çmimit, mes fituesve janë përfshirë emrat më të njohur të letërsisë italiane duke filluar nga Ennio Flaiano më 1947 me "Tempo di uccidere" e për të vazhdua me emra si Alberto Moravia, Mario Soldati, Elsa Morante, Dino Buzzati, Giuseppe Tomasi di Lampedusa, Primo Levi, Goffredo Parise, Umberto Eco, Dacia Maraini, e të tjerë. Dy çmimet e fundit janë fituar nga Sandro Veronesi dhe Niccolò Ammaniti.



Një pjesë e mire e asaj që shkruhet ka të bëjë me tematikën të kontestit të origjinës së shkrimtarit, por të shkruara italisht. Këtu shtrohet pyetja nëse është gjuha i vetmi faktor që sjell përkufizimin e një letërsie apo janë edhe tematikat ato që e përcaktojnë se cilës letërsi i përkasin këta autorë. Kjo është e vështirë të thuhet.

një atmosferë, që të krijohet një ndjesi që na merr frymën në shkrimtarëve. Ishte sikur të thohet që letërsia jonë ishte vetëm një fenomen sociologjik që deri në një farë mase kishte të bënte me letërsinë. Në kohët e fundit gjërat kanë ndryshuar. Pas disa vitesh që kjo letërsi po mbështetej nga shtëpitë e vogla botuese, më guximtare ndaj fenomeneve të reja, disa shtëpi të mëdha botuese filluan të interesoheshin. Ndërkohë duhet pasur parasysh që nga njëra anë lexuesit kishin filluar të afroreshin gjithmonë e më shumë me letërsinë e re, dhe nga ana tjetër numri i emigrantëve në Itali ishte rritur në mënyrë të ndjeshme. Kjo po sjell edhe ndryshime të rëndësishme në përbërjen e shoqërisë italiane. Interesimi i shtëpive të mëdha botuese, recensionet e vazh-

dueshme në shtyp, pjesëmarrja në çmime letrare të rëndësishme i ka hapur rrugën kanonizimit të kësaj letërsie si një fenomen i brendshëm dhe cilësor i letërsisë italiane. Kjo është një çështje shumë delikate që nuk i shpëton as politikës. Ndryshimi i kanonit letrar pasqyron një situatë të re. Vetëperceptimi (l'autopercezione) i shoqërisë italiane ka evoluar, është më plural, ka një tjetër horizont. Natyrisht kontradiktat nuk mungojnë. Periudhat e rënies së ekonomisë sjellin me vete edhe tensione sociale që nuk e kursejnë imigracionin. Nuk është e lehtë të kuptohet si do të kristalizohen këto aspekte.

Duke iu kthyer letërsisë, mbetet problematik përkufizimi i kësaj lloji letërsie, sepse ne i vijon në faqen 14

www.aloartdance.com
aloart
Dance

il vestitario pensato
per le scuole di danza

aloart
Dance

Mobile +39 334 7621125
Fax +39 02 700 438 165
e-mail: info@aloartdance.com

www.aloartdance.com

la qualità aloart
al prezzo giusto..



Presenti in DANZA in FIERA
Padiglione Spadolini - Piano Attico Stand O1



Comune
di Fermo



Comune
di Porto San Giorgio



ACADEMY
GISELLE
DANZA E MUSICA



JOE ARTID FEJZO • GISELLE DANZA E MUSICA

Firmum Dance Festival

Villa Vitali - Fermo - Italy

5-12 Luglio 2009

Porto S. Giorgio in Danza

Workshops - Porto San Giorgio (FM) - Italy

www.crystalofdance.com

PORTO SAN GIORGIO
Filiale di MONTEGRANARO
Tel. 0734.672051 - 328.6136499

info@giselle.it
www.giselle.it

vijon nga faqja 12

përkasim kontekstit prej nga vijmë, por edhe Italisë si kontekst që na pranon.

Një pjese e mire e asaj që shkruhet ka të bëjë me tematika të kontestit të origjinës së shkrimtarit, por të shkruara italisht. Këtu shtrohet pyetja nëse është gjuha i vetmi faktor që sjell përkufizimin e një letërsie apo janë edhe tematikat ato që e përcaktojnë se cilës letërsi i përkasin këta autorë. Kjo është e vështirë të thuhet. Nga ana tjetër edhe vetë fakti që shtrohen të tilla pyetje, tregon se nuk është kaq e thjeshtë të ndahen gjërat me thikë. Sepse këta shkrimtarë kontribuojnë patjetër në letërsinë e gjuhës në të cilën shkruajnë por kontribuojnë edhe në letërsinë e vendeve të tyre të origjinës, pra janë pjesë njëkohësisht pasuruese dhe problematike e të dyjave. Ajo që duket e sigurtë është zgjerimi i horizontit letrar. Kjo lloj letërsie mbart një shije postnacionale.

Ju jeni emigrant historik në Itali, si mendoni ka ndryshuar imazhi i Shqiptarëve këto vitet e fundit?

Ka ndryshuar deri në një farë pike. Fillimisht, u harruan shqiptarët kur ndodhën problemet e konfliktit me lindjen e Mesme. Imigracioni që vinte nga këto vende tërhoqi më shumë vëmendjen. Kështu filloi zbehja e problemit shqiptar. Pastaj erdhi hyrja e Rumanisë në Evropë, emigracioni i së cilës filloi të vuajë të njëjtat probleme që kemi përjetuar ne në vitet '90. Ato që po përjetojnë rumunët sot mund të krahasohen me ato që kemi kaluar në vitet '90. Ndërkohë nga Shqipëria emigracioni është dobësuar sepse dhe vetë Shqipëria ka ndryshuar. Nuk do të thotë se shtresat e mesme shqiptarë është e pasur por është fakt që është më e pasur se më parë. Sot mund t'ia lejojnë vetes të dërgojnë fëmijët me studime jashtë shtetit, mjafton të shihet numri i madh i studentëve shqiptarë në Itali. Kjo ka përmisuar akoma më tepër cilësinë e emigracionit done duke ndryshuar pozitivisht edhe perceptimin e tij.

Ju në fund të viteve '80 ishit student në Tiranë. Si jetohej në atë periudhë në Shqipëri?

Nga ana ekonomike ishte një periudhë katastrofale. Shqipëria në atë kohë ishte e krahaseshme me vendet afrikane. Gjithçka ishte e racionuar, edhe numri i vitami-



RON KUBATI

nave, i proteinave etj. Nga ana politike, komunizmi kishte bërë një gafë strukturale, kishte investuar në formimin e një brezi të ri, shumë më të arsimuar e të kualifikuar se sa brezat e mëparshme. Ky brez kishte mundësinë të shihte edhe jashtë përmasave të diktaturës. Kjo bënte që ky brez të kishte të tjera kërkesa kulturore, të tjera prirje, dhe nga ana ideologjike. Totalitarizmi mendohej të krijonte një realitet të mbyllur monolitik por kur horizonti hapet fillon të shikosh një realitet të ndryshëm. Pra pavarësisht situatës politike, ishte brenda brezit të ri të shqiptarëve të asaj kohe, fryma që e dallonte nga brezat paraardhës dhe që bënte që ky brez të mos ishte më dakord me të. Diktatura në atë kohë ishte dobësuar shumë prej vitesh. Ajo kishte formuar një borgjezi të vetën që në atë pikë kishin arritur deri aty sa u interesonte vetëm mirëqenia e vet ekonomike dhe mbajtja e pushtetit. Ndërsa pjesa tjetër e vendit ishte në varfëri të plotë. Kështu një pjese e mire e atyre që filluan të shprehnin pakënaqësitë e tyre kundëjt diktaturës nuk po e bënë këtë nisur nga krimet e diktaturës por me tepër të nisur nga gjendja e tmerrshme ekonomike në të cilin ishte lënë të dergjej Shqipëria. Në rininë shqiptare lindi një urrejtje shumë e fortë, ku shkaqe ekonomike pra mbizotëronin mbi ndërgjegjen politike të rinisë. Ndërgjegjja politike për një pjesë të mirë të njerëzve nuk ishte ende e formuar mjaftueshëm.

Si po trajtohet komunizmi në Shqipëri si periudhë historike sipas mendimit tuaj?

Analiza kulturore e atyre 50 vjetëve është një analizë që është duke u bërë kohët e fundit por nganjëherë jo me objektivitetin e duhur. Ka një lloj konfuzioni edhe në radhët e emigrantëve. Vështirësitë e emigracionit dhe kritikën ndaj liberizmit pavarësisht se janë objektive apo jo mund të çojnë padashur në mungesën e objektivitetit për sa i takon viteve të shkuara dhe në idealizimin e tyre. Ende nuk është arritur gjakftohtësia e duhur për të analizuar vitet e diktaturës. Jo

detyrimisht dënimi i diktaturës cenon krenarinë e të përkulturit popullit tone. Janë gjëra që duhen ndarë. Por unë jam krenar për sa ka arritur emigracioni shqiptar i cili edhe pse u ndodh në kushte tejet të vështira, pas shumë viteve po arrin të tregojë që është një brez i kualifikuar dhe një emigracion shumë ambicioz.

Ndërsa komunizimi ishte duke rënë, ju në Shqipëri si e perceptonit në atë periudhë?

Që me vdekjen e Enver Hoxhës, ne prisnim që diçka të ndryshonte në Shqipëri. Ndosh-ta jo rënien e plotë e regjimit (ajo ishte ëndërr) por te paktën një zbutje të tij. Vdekja e Hoxhës dhe ardhja e Alias na dha disa shpresa në këtë drejtim. Edhe pse pastaj u pa se shpresat tona ishin te pajustifikuara. Në fundin e viteve '80 u pa një farë hapjeje. Pati një lloj tendence shprese edhe pse e shfaqu në mënyrë të ngathët. Por e dinin shumë mirë që historia kishte ndryshuar. Në pritëm me shumë ankth ndryshimet, por tek ne ato erdhën me shkallëzim. Në janar të '90 qarkullonin fjalë se do të bëhej një protestë në sheshin Skënderbe. Dhe ne dolëm të gjithë të paorganizuar duke thënë po dal xhiro, nuk përzihem, të shofim një herë. Pati disa arrestime. Pastaj filluan të dalin lajme të çuditshme, diçka kishte ndodhur në Shkodër, në Kavajë, por asnjëherë nuk dihej mirë nëse gjërat ndodhnin vërtetë apo jo. Pastaj pamë disa lajme në televizionin italian për disa trazira në Shqipëri. Kjo pastaj përgënjeshtrohej. Në verën e atij viti ndodhi e ashtuquajtura "krizë e ambasadave". Pati një lloj heshtjeje në fillim. Pastaj pas ambasadave në sheshin Skënderbej, partia komuniste solli shumë veta nga fshatrat për të bërë një demonstratë në solidaritet me lidhjen e komunistëve shqiptarë. Unë me disa shokë u futëm në mes të tyre, për ta ndjekur më nga afër, me shpresën se kjo lëvizje do të fishkëllehej, mirëpo nuk ndodhi kështu. Ky qe një zhgënjim shumë i fortë. Në atë kohë dëgjonim shumë Zërin e Amerikës, kishim disa radio Iliria, të vetmet me bateri që kishim dh kur në plazh nuk mbetje më askush, shkonim me radio për të kapur frekuencat e radiove të huaja për tu informuar ç'po ndodhte me ne. Shpresonim që gjërat të ndryshonin. Pastaj dalëngadalë pjesëtarë të liderëve të ardhshëm të Shqipërisë filluan të jepnin intervista. Një sinjal na u duk i kja



Analiza kulturore e atyre 50 vjetëve nën komunizëm është një analizë që është duke u bërë kohët e fundit por nganjëherë jo me objektivitetin e duhur. Ka një lloj konfuzioni edhe në radhët e emigrantëve.

Kubati (i fundit djathtas) mes disa kritikës e shkrimtarësh të huaj gjatë festës së Unita-së Il cammino dei Popoli



e Kadaresë në Francë. Edhe ajo dha një shtysë tjetër. Në mënyrë të çuditshme vetë televizioni shtetëror shqiptar dha lajmin me jehonë. Kjo qe diçka e re. Largohej një personalitet me peshë në kulturën tonë. Kjo ndodhi vetëm pak muaj para lëvizjes së dhjetorit. Në verë Tirana ishte e qetë. Thuhej se do të ndodhte diçka, po po pritej që të ktheheshin studentët, sepse studentët janë gjithmonë ata që sjellin shtysa për ndryshime. Dhe ashtu ndodhi në dhjetor. Pastaj kur studentët protestonin, që në protestën e parë, shpesh edhe qytetarë të Tiranës bashkoheshin me ne. Në protestat e para policia reagonte shumë dhimbshëm. Një herë madje mbaj mend që na u desh të fshiheshim në apartamentet e

pallateve që ndeshëm rrugës për të mos u kapur e rrahur nga policia.

Por pastaj ju u larguat nga Shqipëria si ju edhe shumë studentë të dhjetorit. Dhe shumë pak prej tyre janë të integruar sot në politikën shqiptare.

Në romanin e parë e kam përshkruar këtë fazë. Edhe unë e kam menduar gjatë këtë çështje. Gjatë protestave tona, para se të ndodhte greva e urisë së shkurtit, ndodhte që paradite protestonim në sheshin e qytezës studentore, apo programonim se si do të protestonim, ndërsa hapej fjala se në darkë do të vinin traqet në Durrës dhe kishte mundësi që të shkonim jashtë shteti me ta. Pa e artikuluar mirë këtë mendim, ishim shpesh po disa nga ne që protestonim në mëngjes, ndërsa në mbrëmje kërkonim të ikim nga Shqipëria. Ishte shumë e përha-

(natyrisht jo të gjithë studentet mendonin te largoheshin). Dikush pyeste "e mbarojmë dot grevën për 3-4 ditë se pastaj kam avionin për jashtë shtetit". E gjitha kjo ndodhte në mes të frikës nga policia që mund të na rrethonte. Po të mos kishim pasur të afërm, shokë, që do të kishin mbushur sheshin është vështirë të imagjinosh si do kishte përfunduar puna.

Në një farë mënyre ky mendim monolitik sipas të cilit Shqipëria ishte vendi më i mirë në botë ku mund të jetohej u përmbys. Sistemi kërkonte të bindte njerëzit se Shqipëria ishte parajsja e jashtë ishte ferri kapitalist. Ndërsa në vitet e fundit të komunizmit gjithçka kishte ndryshuar, dhe njerëzit besonin se ferri ishte brenda dhe kudo jashtë Shqipërisë ishte parajsja. Madje kishte nga ata që shpesh hynë në ambasadë pa e parë se çfarë ambasadash ishin.

pur kjo tendence e dy-fishtë. Nga ana emotive barazvlerësonim këto dy gjëra. Dhe unë duke e menduar më pas e përkufizova këtë me kategoritë "altrimenti e altrove", "përndryshe dhe tjetërkund". Kjo dëshirë për tjetërkund ishte e barabartë me dëshirën për altrimenti. Madje ndjenja e tjetërkund ishte edhe më e fortë se përndryshja, sepse e para ishte më e thjeshtë më e arritshme ndërsa protesta do të kishte qenë një proces shumë i gjatë që nuk dihej kur do të përfundonte dhe ku do të na çonte. Ishte komike për disa nga ne të dëgjoje kur flisje midis miqsh, që secili kishte idetë e veta, për itineraret që kishte ndërmend të ndiqte për të ikur nga Shqipëria. Pastaj mendonim si të kombinonim këtë me grevën e urisë

Disa hynin me ndërgjegje nëpër ambasadat franceze, gjermane, apo italiane por disa të tjerë hynin në ambasadën kubane. Pra imagjinata ishte shumë ekstreme, brenda shtetit ishte ferri, kurse jashtë kudo ishte parajsja. Kjo pastaj u shndërrua në një ndërgjegje kulturore të përhapur që kulminoi me largimin masiv me anije. Ishin vite kur të gjithë kërkonin të iknin. Ishte rasti i parë pas shumë vitesh që na u dha për tu hapur me botën dhe ne vendosëm të ikim. Natyrisht në këtë mënyrë iku edhe një pjesë e rinisë që do të kishte dhënë një kontribut shumë të vlefshëm në Shqipëri.

RIFILLON SFIDA.

**DO YOU
CHAMPIONSHIP
RINGO?
2009**



DO YOU RINGO CHAMPIONSHIP. TANI E KE TI RADHËN.

Dje protagonistë në fushë, sot protagonistë jashtë saj: janë "heronjtë" e Kampionatit të shkuar Ringo. Dhe tani, bilibili bie për ty. Mblidh pikët në të gjitha paket, duke filluar nga Ringo Black e rinj dhe Ringo ExtraTime. Nëse përfundon mbledhjen e pikëve brenda 31 marsit merr pjesë në hedhjen e shortit për të luajtur në Championship në qershor 2009. Do të jetë KAKA ai që do t'u ndajë çmimet fituesve. Dhe me pikët e mbledhura, do të kesh menjëherë si dhuratë topin dhe çantën të firmosur nga KAKA. Rregullorja e plotë në ringo.it. Promovim i vlefshëm deri më 31/05/09.

Shuma totale e çmimeve 50.000 €.



Do You Ringo?

Tuta të Romës dhe pantofla. Vështrim i mprehtë, theks roman, shumë pak shqiptar (sidogoftë ka lindur në Durrës), dëshirë për të bërë shaka si çdo djalë 17-vjeçar. "Pothuaj 18, i mbush në prill". Por edhe shumë dëshirë për të folur dhe për të pyetur "Përse?". Ermiri nuk arrin t'i japë përgjigje asaj që i ndodhi: 16 janarin e kaluar jashtë shkollës, ndërhyri në një zënkë për një motor ndërmjet një shokut të tij dhe katër djemve të tjerë. Pastaj grushtet ua lanë vendin teheve të thikave. Dhe ai pushoi së qeni vetëm një djalë i vogël që ëndëron të bëhet inxhinier; që nuk priste një gjë të tillë nga Panucci, që i vjen keq për Samuelin në mbrojtje, që vdes për matematikën dhe është singëll. Jo. Që nga ai moment, nga ora 1 e 20 e një dite të zakonshme, Ermir shndërrohet në një hero. Dhe viktimë e dhunës rinore që nuk njeh kufij.

Po të kishe përpara dhunuesin tënd çfarë do t'i thoje?

Thjesht do të doja ta pyesja pse e bëri këtë. Do të doja të pyesja ç'është nevoja të mbash armë në moshën 20-vjeçare me një thikë apo një levë. Nuk e kuptoj dot, kjo më bën pothuaj kureshtar".

Çfarë ndien tani? Inat?

Jo, as hakmarrje. Do të doja vetëm ta shikoja në sy atë djalë, dhe të tjerët për të kuptuar.

Ndërhyre për të mbrojtur një shok, do ta bëje sërish?

Po patjetër.

Ndërhyr e ëma: Në prindërit jemi egoistë, do të kishim dashur që Emiri ynë të shihte punën e vet. Por ai është gatuar kështu, nuk do të ishte tërhequr kurrë mbrapsht.

U tregove i guximshëm.

Jo bëra atë që duhej bërë. Nëse njerëzit do të kthenin më pak kokën nga ana tjetër, gjithçka do të ishte më e lehtë.

Përse e ke fjalën?

Për bullizmin për shembull. Nëse është kaq i përhapur vjen edhe nga fakti se shumë të pak-të janë ata që kanë kurajë të flasin dhe ta denoncojnë. Ka nga ata që nuk shohin, por mbi të gjitha ka nga ata që bëjnë sikur nuk shikojnë.

Dhoma jote është e gjitha kuqe-verdhë: si ka lindur ky pasion?

Duke jetuar në Trigoria, duke parë lojtarët... Si të mos isha romanist? Deri para pak kohësh shkoja gjithmonë jashtë në Bernardini për të parë stërvitjen. Idhulli im ishte Samuel, sa



Shpresa dhe ëndrrat e Ermirit, i goditur me thikë në një gjimnaz të Romës. Por përveç ngjarjes së kronikës së zezë i riu shqiptar ze vend në gazetën "Il Romanista" edhe për pasionin e tij, La Roma.

"Kur më shoqëroi Totti në shtëpi"

keq më erdhi që u largua.

Po tani kush e ka zëvendësuar në zemrën tënde?

Po ... Totti, dhe De Rossi. Pastaj Montella, që na shoqëronte me makinë.

Ju shoqëronte me makinë?

Kur binte shi dhe në ishin jashtë Trigorias na merrte në makinë. Një herë këtë e bëri edhe Totti. (dhe qesh).

Pse qesh?

Më kujtohet një herë, me një shokun tim. Po prisnim lojtarët, del Cassano, dhe e lagu të gjithin duke kaluar nga një pellg. Totti që shikon skenën, ndalon dhe na shoqëron në shtëpi.

Siç e ka Cassano, dhe siç e ka Totti...

Po - dhe qesh përsëri

Përpara një gote coca-cola dhe disa ëmbëlsirave, është e gjithë familja e heroit të vogël Ermir. Përkufizim ky që atij nuk i pëlqen fare. Aty janë prindërit, motra e sapodiplomuar (me foton e zmadhuar së bashku me të vëllanë në ditën e diplomimit), është këshilltari bashkiak Giuseppe Contenta, nënkryetari i komisionit Sport XII Municipio, Enzo del Poggetto, dhe ak-

torja e re Nicole Murgia, protagoniste e "Tutti pazzi per amore". Të gjithë kanë ardhur për Ermirin, që po bëhet kështu anëtar i Roma Club Eur Torino, duke marrë ftesën nga presidenti i Roma Club Tevere, Paolo Barbatto, për të parë Roma-Siena në 21 shkurt, në tribunë, dhe merr edhe bluzën e romanistit, "Tutta la vita" që do të rreshtohet pas posterit të Tottit që festoi 110 golat e kapitenit dhe që ndodhet përballë krevatit, në dhomën e djaloshit. Kurse mbi tavolinë ndodhet një kompjuter dhuratë e Alemannos. I hapur në Facebook.

S'ke ç'bën kur je në shtëpi...

Po por tani qejfi mbaroi, duhet të kthehesh në shkollë.

Po të hënën kthehem në shkollë. Dhe nuk më vjen keq.

Je nxënës i mirë?

Nuk ia kaloj keq.

Lënda jote e preferuar?

Matematika, më vjen për mbarë edhe pa studiuar.

Gjendja civile..

Singëll. Tani. Pastaj këtu kanë vesh edhe muret...

Projekte për të ardhmen?

Të bëhem inxhinier si motra ime. Jam akoma në vit të katërt,

duhet edhe ca kohë.

Në spital ka pasur një hyrje dalje të dendur të shokëve.

Po nuk mungoi askush. Erdhën edhe profesorët e mi të vjetër dhe drejtoresha, nuk e prisja. Mu bë shumë qejfi.

Ti dhe familja jote keni ardhur në Itali para 10 vjetësh nga Shqipëria dhe jeni mëse të integruar.

Po jetojmë këtu në Trigoria, prindërit e mi paguajnë kredinë si shumë të tjerë. Jemi një familje fare normale.

Ndërhyr e motra : Të integrohesh nuk është e vështirë, mjafton të sillesh mirë duke ndjekur parimet që nuk janë vetëm në Itali. Dhe duke respektuar ligin. Pastaj duhet të ndërtohen marrëdhënie të mira me njerëzit e tjerë sepse nuk jetohe vetëm. Fqinja jonë është për ne si një gjyshe e tretë.

Ju adhuron Trigorian?

Po jetojmë shumë mirë këtu.

Dhe është plot me romanistë.

Ndërhyr këshilltari Contenta

Kjo familje përfaqëson një realitet të mrekullueshëm, janë të integruar më së miri. Për fat të keq nuk është kështu gjithandej, dhe nuk ka kthjellësi për të gjykuar ngjarje dhune si kjo që i ndodhi Ermirit. Le të shpresojmë se në lagje të tjera, si Laurentino, do të krijohen sa më shpejt një fushë, një teatër, dhe të gjitha strukturat e tjera që u nevojiten të rinjve.

Duke iu kthyer asaj dite, Ermir pate frikë?

Jo kurrë. Ndoshta vetëm kur mjekët më thanë se ç'rrezik më kanosej. Por unë nuk i humba ndjenjat dhe isha gjatë gjithë kohës i kthjellët. Flisja dhe merrja frymë, mundohesha të rrija i qetë.

Tani do të kthehesh në jetën e zakonshme duke u munduar ta lësh pas këtë ngjarje.

Do të përpiqem

Paç fat.

Faleminderit dhe forca Roma.

Marrë nga gazeta "Il Romanista"

abonohu në
Bota shqiptare
GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si “gazeta më e mirë për të huajt në itali”

“Bota shqiptare” është prej dhjetë vitesh i vetmi zë në gjuhën shqipe në shtypin italian
“Bota shqiptare” botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali
“Bota shqiptare” nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.
“Bota shqiptare” është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

- Kursen 20% nga çmimi në
pikëshitjet e gazetave
- Gazeta të mbërrin drejt e në
shtëpi pa asnjë shpenzim
të mëtejshëm

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Me ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.

Pak javë më parë në ambientet e Ambasadës shqiptare u inaugurua ekspozita e pikturës e Pjetër Koleci, me origjinë nga Fishta (Lezhë), që prej vitesh jeton e punon në Treviso. Te kjo ekspozitë piktori Pjetër Koleci kishte sjellë 24 punime të përmasave të ndryshme dhe të krijuara në periudhave të ndryshme e me një tematikë që e përcakton me termin "Pafundësi ..." mbasi cdo punim është një shteg kërkimi dhe piktori këtë kohë e konsideron si kohë në të cilën është dukë krijuara personalitetin e tij në krijimtari....."

Ekspozimi në selinë e ambasadës për piktorin Pjetër Koleci përbënte një moment dyfish emocionues e vlerësues. Në Itali ai arriti në '95 me një ekspozitë pikturë (pas përfundimit të studimeve për pikturë monumentale në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë) dhe falë talentit të tij gjeti bashkëpunim me shumë ndërmarje arti në Treviso ku dhe vendosi banimin e tij.

Kështu arti kthehet në një mënyrë jetese për piktorin, një ëndërr për shumicën e artistëve që mes aplikimit, punës së përditshme vazhdojnë studimin e kërkimin e formave e stileve të reja shprehëse të talentit e dijeve artistike. Kjo ekspozitë në ambasadën shqiptare ishte për Pjetër Kolecin edhe një moment bilanci i një rruge artisti të përshtuar jashtë atdheut ku ai mori formimin e tij.

Në ceremoninë e inaugurimit të kësaj ekspozite përveç miqve e dashamirësve shqiptarë e italianë, studentëve e përfaqësuesve të shoqatave shqiptare, personaliteteve të artit e të kulturës ndodheshin edhe vetë ambasadori shqiptar SH. T. zoti Llesh Kola, ministri i kulturës pranë ambasadës shqiptare, poeti i mirënjohur Visar Zhiti, si dhe përfaqësues të Ambasadës së Kosovës në Romë, të cilët me mesazhet e tyre shprehën vlerësimin e interesin për veprat e ekspozuara, të cilat qëndruan në këtë sallë për dy javë në dispozicion të vizitorëve shqiptarë e të huaj.

Me këtë rast ne intervistuar piktorin për të mësuar diçka më shumë mbi biografinë e formimin e tij dhe projektet që shoqërojnë gjithnjë artistin.

Al.Te.



Përpiqem të pikturoj jo njerëzit, por botën e tyre të brendshme



Pjetër Koleci me ambasadorin shqiptar në Itali Llesh Kola. Lart salla e madhe e Ambasadës shqiptare në Romë gjatë ekspozitës dhe posteri në një dritare të ambasadës



Me piktorin Pjetër Koleci, i cili sapo ka inauguruar personalen e tij në ambasadën shqiptare në Romë.

Në biografinë tuaj tregoni që ishte mësuesi juaj i shkollës fillore në Fishtë, Pjetër Gjoni, ai që njo-hu talentin tuaj për pikturë. Si e kujtoni këtë episod ?

Isha në fillore. Kur bënim vizatim, unë ndihesha i kënaqur dhe vizatoja me shumë dëshirë. Kishim një problem të vogël atëherë në shkollë, nuk kishim fletë vizatimi. Kështu kur mbaroja fletoren time, mësuesi Pjetër Gjoni me



jepte fletoret e nxënësve të tjerë.. e kështu unë kisha mundësi të vizatoja gjithnjë.

Çfarë "peshe" ka Fishta, vendlindja juaj, në formimin tuaj si artist?

Fishta është vendlindja ime dhe e mbaj gjithnjë me vetë..! I kam krijuar dhe një faqe interneti www.fishta.tk. E dua shumë. Kur isha fëmijë, prindërit e mi krahas edukimit fetar më recitonin pjesë të "Lahutës së Malcis" dhe të veprës së At Fishtës. Mendoj që njeriu lind me talentin, po pastaj sipas mundësive e zhvillon ate. Për këtë falënderoj prindërit e mi që më dhanë mundësinë për të studiuar.

Studimi në liceun artistik "Prenke Jakova" Shkoder i dha formë talentit tuaj. Cilët nga profesorët e kësaj shkolle kanë lënë gjurmë në këtë formim? Profesorët si Liljana Cefa, Ismail Lulani, Jakup Keraj, Danish Jukniu, Iqbal Kalaja kanë kontribuar në formimin tim artistik të asaj kohe..

Për fat të ekzistencës së një regjimi diktatorial në fuqi e "luftës së klasave" juve, si shumë të tjerëve, ju mohohet vazhdimi i studimeve të larta në Akademinë e Arteve në Tiranë, ku arrini të regjistrohëni dhe të përfundoni studimet vetëm pas vitit 1991. Çfarë kujtoni nga këto dy ngjarje. Sa gjurmë kanë lënë te ju e te krijimtaria juaj e re e asaj kohe?

Kam konkuruar dy herë për në Akademi të Arteve në vitet e diktaturës dhe nuk fitova!

U zhgënjeva, pse mendova se nuk vlej si piktor. Në vitin 1992 fitova të drejtën e studimit për në Akademinë e Arteve. Në fund të konkur-

vijon në faqen 20



Veç një muaj pas daljes në treg romani autobiografik i Kledi Kadiut "Meglio di una favola" ka shitur 20.000 kopjet e para dhe Mondadori ka hedhur në treg botimin e dytë. Suksesi i radhës i balerinut shqiptar i cili promovon librin anembanë Italisë në librari duke nënshkruar kopje të autografuara si këtu në një qendër tregtare në Romë.

Për një listë të librarive të gjithë Italisë ku Kledi do të jetë i pranishëm muajt e ardhshëm përditësohuni në www.kledi.it

rimit komisioni na bënte një test. Mua ma bëri Ali Oseku, profesor dhe ish i burgosur politik. Kur pa datëlindjen time, ngriti kokën dhe qeshi "ku ke qenë këto vite?" "Në krijimtari të lirë!" - iu përgjigja!

Në të njëjtën kohë mora vesh se më parë nuk kisha fituar për arsye politike.

Mundësia e studimit në vitet e demokracisë ka ndikuar shumë sepse shkolla ka pasur gjithnjë bashkëpunim me jashtë. Kemi marrë leksione nga profesorë dhe artistë të akademive Europiane e Amerikane.

Ku keni ekspozuar për here të pare punimet tuaja? Me çfarë tematike e punimesh u prezantuat e si u prit nga publiku?

Ekspozita e parë personale është në Galerinë e Arteve në Lezhë ku kam prezantuar punime shkollore. Kujtoj që ka pasur shume polemike, për konceptin abstrakt të punimeve dhe nudot e paraqitura.

Sa ka ndikuar ardhja në Itali në krijimtarinë tuaj?

Kam studiuar në shkollë artin italian. Duke qenë në kontakt me artin e një vendi si Italia dhe me aktivitete të rëndësishme një ndër të cilat

PJETËR KOLECI

“Përpiqem të pikturoj botën e njerëzve”

vijon nga faqja 19



"La Biennale di Venezia" është i paevitueshëm ndikimi. Vazhdoj të studioj për pikturën nëpërmjet internetit dhe jam gjithnjë në kërkim. Por pa iu larguar kanavacës.

Sa mundësi e pengesa keni gjetur për të afirmuar talentin në vend të huaj?

Mundësitë: këtu janë njohës të artit - pengesa: shumë. Duhet të krijosh vetë, të paraqesësh punime emocionuese për publikun. Mendoj që suksesi i pikturës sime është ngjyra, e veçantia e realizimit teknik që është unike. Kam pasur shumë pengesa për sa u përket

konkurseve të artit dhe ekspozimit në galeritë e njohura. Dhe vazhdoj të kem...

Mbase kjo ndodh dhe në Shqipëri. Kam bërë një kërkesë për ekspozitë pranë Galerisë Kombëtare të Arteve. U bënë dy vjet dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje. Jam në pritje!!!!

Ku keni ekspozuar gjatë këtyre viteve?

Në Treviso e Venezia e vazhdoj të punoj si dekorator, afreskist dhe Trompe l'oeil (arti i iluzionit)

Ekspozita juaj në selinë e Ambasadës në Romë. Një vlerësim i dyfishtë për krijimtarinë e një artisti. Si e pritët ftesën e këtij ekspozimi?

Me kënaqësi të madhe. Të paraqesësh punën tënde në shtëpinë tënde, ndonëse larg saj.

Çfarë prezanton piktura juaj sot e projektet tuaja?

Nuk pikturoj persona por personalitetin e tyre, tek një gjë e madhe kërkoj të voglën.

Projekte: të realizoj gjithnjë vepra emocionuese për shikuesin, dhe të vazhdoj të kem mundësinë për të ekspozuar punën time.

Bisedoi Albana Temali



Përfaqësia e Kosovës feston njëvjetorin e pavarësisë në Romë



Elegante e dinjitoze përvjetori i parë i pavarësisë së Kosovës festuar në Romë në Hotel Parco dei Principi më 17 shkurt. Një kuintet harqesh që luante në sfond muzikë klasike dhe dhjetëra diplomatë të huaj në Itali, miq shqiptarë e italianë.



FOTOT FERDINAND BJANKU

Sapore di casa

Në një dado-supe të vogël, një kuzhinë e madhe.

Me Maggi® mund të fitosh një Kuzhinë

Jepi shije specialiteteve tuaja me një dado-supe (ekstrakt) të thjeshtë dhe mund të fitosh një kuzhinë të mrekullueshme.

Blej një konfeksion me dado-kuzhine **Maggi**, plotësoje kuponin me të dhënat tuaja dhe dërgoje së bashku me kodin me viza të artikullit dhe fletëpagesën (scontrino) në adresën e dhënë: të gjithë kuponët që mblidhen brenda datës 09-04-15 do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për një kuzhinë të mrekullueshme.

Konsulto rregulloren në seksionin e caktuar për kuzhinën etnike në internet www.stranieriinitalia.it dhe zbulo librin e recetave të kuzhinës ndërkombëtare që ofrohet nga Maggi® edhe ti mund të dërgosh recetën tënde!

Stranieri in Italia

*campi non obbligatori

Nome _____ Cognome _____

Sesso* F M Residente a: Città _____ Prov _____

Via _____ n° _____ Cap □□□□□

Tel _____ email* _____

KONKURSI ESISTE! VLEPSHËNIA: DATA 08-11-01 DERI ME 09-03-31. SHORTI PËR PUNIMTORI: HEDHJET BRESIDA DATES 09-04-30. VLERË E PËRQUTITSHMË E COMBIDE ESHTË 0,30 €. PËR ZËR (PËR SHIRTYSHËNË) RREGULLOJA E FLETË PAGESËSË NË INTERNET: www.stranieriinitalia.it UDE: 02-802041 NUMRI: 02-5454-5454.

Buono Sconto

0,30€

482050085

Valido per l'acquisto di una confezione a scelta tra Dado Ricetta Mediterranea e Dado Ricetta Originale

AVVERTENZE AL CONSUMATORE - Per ottenere lo sconto il buono deve essere presentato al negoziante entro il 01/06/2009. AVVERTENZE AL RIVENDITORE - Per ottenere il rimborso di questo buono sconto, si prega di inviare il medesimo alla Nestlé Italiana S.p.A. presso VALASSIS S.r.l. - Casella Postale 14250 - Via Grosio 10/8 - 20151 Milano. La Società rimborserà questo buono sconto solo se utilizzato dal consumatore per l'acquisto del prodotto. Ogni altro uso verrà perseguito nei termini di legge. Non saranno rimborsati buoni non integri in ogni loro parte o che comunque presentino segni di manomissione o alterazioni. Il rimborso dei buoni potrà essere sospeso qualora venisse rilevata la non corrispondenza tra il numero dei buoni presentati e la quantità di prodotto acquistato.

Inserisci i tuoi dati e spedisci insieme al codice a barre e lo scontrino di acquisto alla casella postale: Vinci una Cucina con Maggi c/o C.S.M. - Casella Postale 150 - 20187 SEGRATE (MI). I dati dei concorrenti serviranno per partecipare al concorso e saranno registrati elettronicamente. Titolare dei dati è Nestlé Italiana S.p.A. - Via G. Richard, 5 - 20143 Milano. Responsabili del trattamento dati sono: CSM - via Brescia, 9 - 20096 - Poglietto (MI); Ogilvyone Worldwide S.r.l. - Via Lancetti, 29 20158 Milano e Intouch - Gruppo Europ Assistance Via Crema, 34, 20135 Milano. Fornendo ulteriore consenso, i dati dei concorrenti potranno essere utilizzati per fini informativi, di ricerca e per l'eventuale invio gratuito di materiale promozionale e pubblicitario da parte di Nestlé Italiana S.p.A. e di Sanpellegrino S.p.A. Ai sensi dell'art. 7 d.lgs. 196/03, i consumatori potranno consultare o far modificare i propri dati od opporsi al loro utilizzo scrivendo a Nestlé Italiana S.p.A. - Servizio Consumatori - Casella Postale 163 - 20101 Milano.

accosento

NON accosento



Më 22 mars, në maratonën e Romës, mes 100.000 vrapuesve dhe 200 atletëve me aftësi të kufizuara nga e tërë bota, merr pjesë edhe 40-vjeçari shqiptar Haki Doku.

Veçantia e lajmit? Haki Doku jeton në një karrige me rrota. Në një aksident të vitit 1997, në Milano ku jeton, Hakiu ka dëmtuar shtyllën kurrizore. Por ky fakt nuk e ka penguar që, edhe pse mes shumë e shumë vështirësish, të bëhet i pavarur nga të tjerët e të vazhdojë jetën e tij - me siguri shumë ndryshe nga ç'mund ta kishte menduar para atij viti të mbrapshtë, por sidoqoftë shumë aktive - me studime, punë, krijimin e familjes madje edhe me sport.

Ai ka studiuar informatikë e turizëm e prej vitit 2000 punon pranë Kompanisë financiare FinSev spa si Programator informatik. Në vitin 2005 është martuar dhe sot është baba i lumtur i Marios njëvjeçar.

Në vitin 2000 është regjistruar në Skadrën Pop 84 të Milanos e ka marrë pjesë në gara atletike me karrocë paraolimpike; në vitin 2002 është regjistruar në skuadrën G.S. Rancilio e filloi të merret me sporte dimërore, ski në borë e hokej në akull, duke marrë pjesë në kampionatin italian dhe atë europian të Hokejt në akull në Gjermani.

Në vitin 2003 ka lënë sportet dimërore për t'u marrë vetëm aktivitetin me biçikletë (handbike), sport në të cilin ka arritur suksese të konsiderueshme në gara të rëndësishme si në maratonën 42 km të New York-ut, në kampionatin italian, europian e botëror. Në vitin 2007 ka përfaqësuar Shqipërinë në maratonën 42 km të Romës dhe ka dalë i teti.

Hakiu tregon për Shqiptarin e Italisë që u është shumë mirënjoh-

Në jetë vrapohet edhe mbi një karrige me rrota . . .

Një aksident i rëndë e ka shtrënguar në karrocë më 1997. Por shqiptari 40 vjeçar nuk është dorëzuar e merr pjesë rregullisht si atlet në sportet paraolimpike.

hës të gjithëve që e kanë ndihmuar. "Jam i lumtur që jetoj në Itali - thotë Hakiu - edhe pse aksidenti fatkeqësisht më ndodhi këtu. Është shumë pak nga ana ime të falënderoj të gjithë ata që më kanë ndenjur pranë nga dita e aksidentit deri më sot dhe më kanë ndihmuar në të gjitha aspektet".

Por ka një pishman dhe një

Komiteti që deri më sot nuk ka pasur fatin të funksionojë". Tregon gjithë pasion që me një grup njerëzish, profesionistë dhe të sinqertë po punon për organizimin e disa aktiviteteve sportive në Shqipëri, për të sensibilizuar sa më shumë opinionin publik sportin e personave me aftësi të kufizuara, që "në Shqipëri sot jetojnë të izoluar për shkak të mentalitetit të mbyllur e të vjetër kulturor e sportiv".

"Unë jam ndihmuar unë shumë e shumë vetë, dhe sot dëshiroj të ndihmoj personalisht të tjerë që kanë nevojë për mua, duke filluar nga sensibilizimi për të drejtat e personave me të drejta të kufizuara, veçanërisht në sport".

Këtë vit, Hakiu do të marrë pjesë jo vetëm në maratonën e Romës por edhe në ato të Milanos, New York-ut, Padovës, Torinos, Modenës dhe Trevisos. Dhe jo vetëm në maratonë por edhe në Kampionatin Europian që t'i jepet e drejta të shkojë në Lojrat paraolimpike të Londrës në vitin 2012.

"Fitore dhe vetëm fitore! - kjo është motoja ime thotë Hakiu - Për vete e për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në Shqipëri, për t'i bindur të gjithë që sporti luan një rol vendimtar për të dalë nga izolimi"

Keti Bicoku



ëndërr Hakiu e për realizimin e saj po punon me të gjitha forcat e tij. "U përpoqa me shumë punë, stërvitje e mundime të merrja pjesë në Lojrat paraolimpike të Pekinit në shtator 2008. Nuk ia arrita dot, për shkak të mosfunksionimit korrekt të Komitetit paraolimpik shqiptar, ndaj i kam hyrë punës për riformimin e këtij

Ecja me Gertruden time dhe qeshja me vete. Vetëm para pak ditësh kisha mësuar se emri "Gertrude" vjen nga një fjalë e vjetër gjermane që ka kuptimin forcë. Unë, karroca ime me rrota me emrin Gertrude dhe "forca" bashkë me ne...

E si të mos qeshja?!

Kam tre vjet në karrige me rrota, tashme jam fikse (kështu thuhet, por nuk e di nga kush), nuk lëviz dot pa të. Sa herë që e shoh, nuk di mirë se çfarë të mendoj... Love, apo Hate? Nuk kam një margaritë...

Më vjen mirë që e kam, më ndihmon kur unë nuk mundem (gati gjithmonë), më krijon siguri (nganjëherë kjo gjë është mjaft e rrezikshme), më jep pavarësi, mund të bëj ç'të dua (pothuajse) e sidomos, të iki kur të dua, sepse nuk ka tmerr më të madh sesa të vazhdoj të rrih ku e kur nuk dëshiron, ose pasi ke thënë të fundit (gjatë një zënke, psh). Provoje, ke për të më dhënë të drejtë. Do thuash, me gjithë gjërat e tjera të cilat i bën për forcë, ose ato të tjerat që nuk i bën dot fare, shkon e të ngelet mendja këtu! Do të të përgjigjesha si iu përgjigja një mjeku dermatolog i cili, kur unë mjaft e shqetësuar, nga frika se mos më përhapej në trup a fytyrë, i tregova një shënjë të bardhë që prej pak kohe më ishte bërë në dorë, e, pra, ai, qyp, pa e vrarë fare mendjen për mua e për sikletin tim, më tha, zonjë, ju keni një problem tjetër më të madh, mos...

Nuk po them si iu përgjigja se më vjen turp, por edhe kush më bën ndonjë pyetje nga ato që përmenda më parë, meriton të njëjtën përgjigje-përturp.

Kurse herë të tjera kur shikoj Gertrudën - kjo gjë ndodh kur nuk jam e ulur në të - më vjen të vë kujtën e të iki me vrap (!), aq fuqishëm më përplasat në fytyrë (e gjithkund) pamundësia ime.

Ndodh sidomos kur shikoj veten në fotografi. Atëherë unë vetëm shikoj veten time në Gertrude, misioni i saj i ndihmës për momentin ka mbaru-

LOVE & HATE

Unë dhe Gertruda ime



Kam tre vjet në karrige me rrota, tashmë jam fikse (kështu thuhet, por nuk e di nga kush), nuk lëviz dot pa të. Sa herë që e shoh, nuk di mirë se çfarë të mendoj... Love, apo Hate? Nuk kam një margaritë...

ar dhe unë e kam harruar që ndjenja ime për të ishte Love e kulluar (njeriu harron shpejt, por ndoshta duhet thënë për shqyrr!), dhe tani që si nga një ballkon shikoj fotografinë dhe vështroj veten time të ngulur në Gertrude, Hate për të ngjitet furishëm e bëhet e padrueshme, aq sa unë e heq sysh sa më shpejt të jetë e mundur foton se më vjen turp që nuk di të vendos një herë e mirë: Love, apo Hate.

Kur jam në krevat, dua të ngrihem e përpiqem si brumbulli që është kthyer padashje mbi kurriz, dëshiroj të jem mbi Gertrude, e kur jam mbi Gertrude e njerëzit më vështronjë si të trembur - nuk e kisha ditur që bëja këtë efekt, ndërkohë kuptohet që mendojnë "larg meje, shqyrr!" - dëshiroj të jem në krevat. Më duhet të vendos. Nuk e kam në dorë.

Gertrude imja, forca ime - duhet të qesh?! Sikur nuk më vjen, sepse me Gertruden unë vërtet ndihem më e fortë. Shkoj më e sigurtë, shplodhem kur jam e lodhur (ndërkohë që jam gjithmonë e ulur!) dhe bëj gjëra për të cilat më është thënë "aha, iku ajo kohë!" - atëhere

është Love.

E kur nuk hyj dot aty ku dua se është ngushtë, apo kur Gertrude ka ngecur në një cep e nuk i lëvizin rrotat, kur më dalin djersë se më duhet të bëj një manovër shumë të vështirë e të gjithë herët e tjera kur njerëzit më shohin me pikëllim e thonë "sa e re, e gjora", sepse nga pikëllimi ngatërrohen e kujtojnë se një njeri që është në karrige me rrota, s'mund të ketë veshë e për më tepër s'mund të ketë mendje - është Hate.

Më duhet të vendos. E thashë një herë që nuk mundem. Nuk kam një margaritë!

Puna është se unë kam karrigen me rrota me emrin Gertrude dhe kam edhe mendje.

E, atëhere, është Love dhe Hate. S'mund të jetë ndryshe.

Dori

Sh. i red. Dori është shoqja dhe bashkëpunëtorja jonë. Jeton në Romë, është e bukur dhe gjithnjë e qeshur duke mos e lënë sëmundjen ta vërë poshtë shembull i rrallë optimizmi dhe dashurie për jetën. Pas diplomës në Tiranë, po përfundon diplomën e saj të dytë në La Sapienza. E do të bëjë të tjera gjëra të bukura, siç ka bërë gjithmonë. Dorit do donim t'i ngjanim.

IL SANGUE LANGUE
la donazione del sangue ha bisogno di una svolta
facciamone anche quattro
rimbocchiamoci le maniche
www.sanguelangue.it 800-012283

Dashnor Kaloçi

Egjithë veprimtaria politike e zhvilluar prej mërgatës antikomuniste shqiptare në shtetet e ndryshme të botës, kundër regjimit komunist të Enver Hoxhës, që nga fillimi i vitit 1945 e deri në fundin e viteve '80, duket se ka qenë nën vëzhgimin e rreptë e survejimin e vazhdueshëm të agjentëve të Zbulimit shqiptar (Sigurimi i Shtetit), të cilët ishin të kamufluar nën petkun e diplomatit nëpër ambasadat dhe përfaqësitë tona jashtë shtetit. Kjo gjë shihet më së miri dhe konfirmohet edhe nga dokumente të ndryshme arkivore të cilat i përkasin korrespondencës së vazhdueshme të titullarëve më të lartë të Ministrisë së Jashtme në Tiranë, me diplomatët e saj të gjitha rangjeve në përfaqësitë tona jashtë shtetit. Këto dokumente, të cilat janë mbajtur tepër sekrete për dekada me radhë, (prej dy-tre vjetësh janë të deklasifikuara) bëhen publike dhe hedhin dritë mbi një nga periudhat më të errëta të regjimit komunist të Enver Hoxhës, i cili i kishte kushtuar një rëndësi të dorës së parë survejimit të kundërshtarëve të tij politikë në të gjitha shtetet e botës ku ata jetonin e vepronin. Po ku u vendosën fillimisht krerët e mërgatës politike shqiptare, cilat ishin kampet që u ofruan atyre anglo-amerikanët, si u organizuan ata në grupe e parti të ndryshme dhe cila ishte veprimtaria e tyre politike kundër regjimit komunist të Hoxhës?

"Shtypi i kriminelëve shqiptarë"

Siç duket dhe nga dokumentet arkivore në të cilat është mbajtur korrespondenca e plotë e Ministrisë së Jashtme në Tiranë me legatën shqiptare të Romës, një nga detyrat kryesore të asaj ambasade ka qenë edhe vëzhgimi i kujdesshëm i të gjithë shtypit të mërgatës politike shqiptare që dilte në vende të ndryshme të Europës Perëndimore. Kjo gjë shihet qartë edhe në një nga relacionet sekrete të njërit prej diplomatëve të asaj legate për Ministrinë e Jashtme në Tiranë, kumës të tjerash ai shkruan: "Relacion mbi shtypin e kriminelëve në vendet kapitaliste". Gjatë këtyre muajve të fundit në shtypin e kriminelëve shqiptarë të arratisur në Itali dhe në vende të tjera nuk ka ndonjë gjë shumë të veçantë për t'u theksuar. Ata kanë vazhduar si edhe më parë që të shkruajnë artikuj e lajme shpifëse dhe t'i shpërndajnë këto kudo që ka shqiptarë (duke i nisur me postë ajrore jashtë Italisë), dhe në të gjitha agjencitë e shtypit reaksionar. Siç dihet, ajo që del në rregull nga të gjitha gazetat është "Shqipëria", dhe pastaj "L'Albanie libre". "Shqipëria" del më e përgatitur dhe nga ana estetike më e bukur. Të tjerat nuk dalin në rregull, "Flamuri" tani ka dalë në 6 numra përmjeherësh.

Dokumentet e panjohura të Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme bëjnë publike raportet e informacionet tepër sekrete të Zbulimit Shqiptar në vitet 1945-1979, lidhur me aktivitetin e emigracionit shqiptar antikomunist në Perëndim. Të gjitha detajet se ku ishte vendosur pjesa më e madhe e mërgatës antikomuniste shqiptare, kush ishin krerët kryesorë të saj, në sa parti ishin grupuar, çfarë gazetash e revistash botonin dhe e gjithë veprimtaria e tyre politike për të rrëzuar regjimin komunist të Enver Hoxhës



MËRGGATA ANTIKO

Kur ambasada shqiptare në Ro

"Zëri i Ballit Kombëtar" ka dalë numri 6 (këtë nuk e kemi marrë akoma), buletini i lajmeve që nxjerr komiteti "Shqipëria e Lirë" megjithëse del i mirë, tani e ka rraluar publikimin e tij. Nga shpifjet që kanë kurditur këta dhe nga sa është shkruar, më shumë shënojmë: a) Kanë organizuar këtu në Romë një konferencë shtypi për të cilën kemi folur edhe më parë. Në këtë konferencë është folur nga Hasan Dosti dhe nga Reshat Agaj, mbi gjoja regjimin e burgjeve të kampeve që gjoja ekzistoka në Shqipëri. Për këto ata kanë dedikuar një numër të tërë të buletinit të tyre dhe kanë shkruar pothuajse të gjithë. Shtypi i verdhë, siç e kemi shkruar, ka përfituar nga këto për të shkruar mbi vendin tonë. Fushata kundër vendit tonë për të përgatitur shpifje mbi gjendjen në Shqipëri, vazhdon gjithnjë nga këta dhe gjithnjë vazhdojnë ta furnizojnë shtypin reaksionar me këto lajme. b) Me rastin e festës së 28 Nëntorit këta kanë nxjerrë numra shumë të përgatitur dhe janë përpjekur që të tregojnë se të vetmit që festojnë 28 Nëntorin janë këta. c) Në vazhdim të punës së tyre që të helmatisin shqiptarët kudo që janë dhe me qëllim që

të dobësojnë punën tonë, kanë shkruar disa komente mbi shqiptarët e Amerikës e kanë goditur gazetën "Liria" e "Dielli", që bëkan punën e qeverisë sonë. Gjithashtu, kanë shkruar artikuj mbi vizitën e Zef Palit në Turqi dhe mbi shqiptarët e atjeshëm. ç) Në botimet e tyre janë dukur si gjithnjë edhe kontradiktat që kanë, sidomos këto janë dukur në "Zëri i Ballit Kombëtar" dhe "L'Albanie libre", megjithëse në masë më të vogël nga në muajt e mëparshëm. Këto janë disa nga çështjet me rëndësi që kanë kurditur kohët e fundit. Nuk po shënojmë këtu më gjatë gjëra të tjera që do të dalin nga leximi i shtypit që i dërgohet ministrisë. Duke qenë se shumë nga këto çështje mund të goditen nga gazeta jonë "Shqipëria e Re", do të qe mirë që të organizonim dërgimin, me anë të postës, nga një kopje për secilin gazetë menjëherë porsa e marrim. Po të shikohet e arsyeshme një gjë e tillë, mund të fillojmë që t'i nisim me anë të Budapestit, siç bëjmë me kopjet e shtypit". Romë 10.01.1953 Sekretari i dytë i legatës (Kleanth Andoni).

Kërkesat e Ali Këlcyrës tek angloamerikanët

Pas përshkrimit që diplomati i legatës shqiptare të Romës S.K. u bën kontradiktave të vazhdueshme që ekzistonin në atë kohë midis grupeve të ndryshme të emigracionit politik shqiptar në shtetet perëndimore, ai vazhdon relacionin e tij për Ministrinë e Jashtme në Tiranë, duke shkruar: "Grupet që sot qëndrojnë jashtë vullnetit të tyre natyrisht, përjashtë nga Komiteti, janë gjithnjë po ato: Blloku Independent, Balli Kombëtar i Ali Këlcyrës dhe Lidhja e Dytë e Prizrenit. Krerët e këtyre tre grupeve janë po ata që kemi njoftuar më parë. Këto grupe nuk kanë as sa për formë një platformë politike dhe as organizative. Blloku dihet me kohë që është një organizatë thjesht spiunazhi e neofashistëve italianë kundër Republikës sonë. Si e tillë ajo përpiqet që të grumbullojë nga radhët e emigracionit tradhtar sa më shumë njerëz dhe grupe që të mbështesin politikën armiqësore të reaksionit dhe qarqeve kapitaliste italiane kundër vendit tonë. Në këtë drejtim ka arritur të bëjë më vete Ali Këlcyren dhe

Majtas: Nëpunësit e ambasadës shqiptare në Romë në dimrin e vitit 1971, një ndër të rrallët dimra me deborë në Romë
 Foto e madhe: Komiteti "Shqipëria e Lirë" në 1949 i ftuar në Radion BBC në Londër. (nga e majta) Petrit Kupi, Said Kryeziu, Alfred Andoni, Walter Kholarz, Mithat Frashëri, Ihsan Toptani, Zef Pali, Abaz Kupi, Anton Logoreci, Tajar Zavalani dhe Nuçi Kota.
 Djathtas: Krerë të mërgatës antikomuniste: Skënder Dume, Muharrem Bajraktari, Ihsan Toptani dhe Miftar Spahija, në kampin e Llavrosit në Greqi në 1951
 Poshtë: Gazeta "Shqipëria" e Komitetit "Shqipëria e Lirë" dhe relacionet sekrete të ambasadës shqiptare në Romë për Tiranën.



ANTIKOMUNISTE Romë bënte punën e Sigurimit

ata pasonjë të paktë të tij, duke u mbështetur në faktin se Këlcyra është një nga armiqtë kryesorë të krerëve agrarë, të cilët e kanë zburar nga radhët e tyre. Sot Këlcyra është protagonist kryesor i kërkesave pranë amerikano-anglezëve për t'u zgjeruar Komiteti, me pjesëmarrjen e të gjithë grupeve tradhtarë. Në këtë mënyrë ai inspiron të bëhet një element kryesor në radhët e Komitetit. Si ky, ashtu edhe Blloku gjer më tani nuk kanë pasur asnjë sukses dhe asnjë mbështetje serioze nga ana e amerikanëve dhe anglezëve, të cilët vihen në roje prej "agrarëve" sidomos, si manovra këto të inspiruara nga italianët që të përforcojnë pozitën e tyre në radhët e emigracionit tradhtar. Veprimtaria e këtyre dy grupeve është e përbashkët. Ali Këlcyra, i cili një ose dy herë në vit nxjerr një gazetë të grupit të tij me emrin "Zëri i Ballit Kombëtar", propagandën e tij në këtë drejtim e ushtron me anën e organit të Bllokut "L'Albanie libre" e cila kohët e fundit ka filluar të dalë rregullisht një herë në çdo pesëmbëdhjetë ditë. Politika në mes Komitetit, në radhë të parë "Agrarëve" dhe "Bllokut" e "Ballit"

të Këlcyrës në çështjen e bashkimit të gjithë grupeve, ka shkuar duke u acaruar vazhdimisht. Kjo ka arritur gjersa të akuzojnë njëratjetrën për përgjegjësi kolaboracioniste, njëra me fashistët italianë dhe tjera me okupatorët gjermanë, duke e maskuar kështu aktivitetin e këtyre grupeve dhe krerëve jo vetëm gjatë kohës së okupacionit në Shqipëri, por edhe për aktivitetin jashtë shtetit. Aktiviteti i Ali Këlcyrës, krahas me atë armiqtësor kundër Republikës sonë, konsiston edhe në tentativa për të shtuar radhët e tij, me qëllim që në këtë mënyrë të imponojë pjesëmarrjen e tij dhe miqve të tij në Komitet. Për këtë arsye, herë pas here ka vajtur në Greqi dhe Egjipt. Në Greqi, ku është një numër tradhtarësh, ai ka shkuar dhe para nja dy muajve dhe ka vizituar kampet, duke bërë propagandë për "partinë e tij" dhe kundër agrarëve, të cilët i demaskon si tradhtarë dhe bashkëpunëtorë me të huajt. Duket se nuk ka pasur sukses, meqenëse i ka dalë fare boja përpara tradhtarëve të tjerë, ashtu si dhe shumë krerëve të tjerë shokë të tij të vjetër apo

të rinj. Po në këtë rast ai ka qenë edhe në Egjipt, ndoshta për t'u takuar me Zogun, nga i cili duhet të financohet në mënyrë indirekte si kundërshtar i "agrarëve", tek të cilët Zogolli shikon "pengesën" kryesore për ëndrrat e tij monarkiste në Shqipëri në "një të ardhme" që mundet të shpësojë. Bashkëpunimi aq i ngushtë në mes Bllokut dhe Ali Këlcyrës dhe i këtyre të dyve me "Lidhjen e Prizrenit" në një shkallë më të ngushtë, ka bërë që Ali Këlcyra të dalë edhe një herë akoma, hapur e zyrtarisht, shërbëtor konseguent i interesave të neo-fashistëve italianë kundër Shqipërisë".

Veprimtaria në Jugosllavi

Pas asaj pjese të relacionit ku bëhet fjalë për aktivitetin politik të Ali Këlcyrës, një prej krerëve më kryesorë të emigracionit antikomunist shqiptar në Perëndim, i cili përfaqësonte një prej grupeve të Ballit Kombëtar, diplo-

mati S.K. informon shefat e tij në Tiranë mbi lidhjet e grupeve antikomuniste të Perëndimit me emigrantët shqiptarë që ndodheshin në Jugosllavi. Lidhur me këtë raport, të cilin ai e ka titulluar: "Lufta e grupeve të ndryshme këtu për infiltrimin e influencës së tyre në tradhtarët që gjenden në Jugosllavi", midis të tjerash ai shkruan: "Më në dukje në garë në këtë drejtim janë ai i Bllokut dhe ai Agrar. Që të dy kanë qëndrime të ndryshme karshi të ashtuquajturit Komitet i Apostol Tenefit i krijuar nga titistët. Ndërsa grupet pjesëtare të Komitetit të imperializmit angloamerikan, godisnin me propagandën e tyre karshi fashistëve titistë jugosllavë, që të dy palët mbajnë qëndrim që lë përshtypjen e një dëshire për afrim. Blloku "independent" përpjet të shfrytëzojë emrin gjoja influent të Gjon Markagjonit, karshi atyre kriminelëve dhe atdhetarëve nga zonat e Veriut të Shqipërisë që kanë dalë në Jugosllavi. Agrarët nga ana e tyre përpjeten të futin në punë disa elementë simpatizantë të tyre atje për të dobësuar "punën" e bllokistëve. Sikundër duhet të vini re në gazetën e fundit të këtyre dy grupeve, polemika në këtë drejtim ka marrë një rrugë e cila do të çojë më shumë në përçarje. "Internacionalja e lirisë". Këto kohët e fundit sidomos ka filluar të dalë më shumë në skenë kjo farë organizate e agenturave imperialiste, e cila ka për detyrë të grumbullojë rreth vetes sa më shumë "intelektuale" tradhtarë të vendeve të Demokracisë Popullore, e në radhë të parë gazetarë. Është një degë e "Internacionales së verdhë" dhe e ka qendrën e aktivitetit të saj këtu në Romë. Presidenti i saj është kriminel shqiptar Eqrem Telhaj. Ka për qëllim që të gënjejë opinionin publik rreth gjendjes nëpër vendet tona, dhe për këtë arsye herë pas here organizojnë intervista shtypi dhe mbledhje të gjera, ku flasin me radhë tradhtarë dhe kriminelë të vendeve tona. Brenda këtyre dy muajve të fundit janë bërë dy mbledhje të tilla të gjera, duke ftuar edhe miq të tyre nga fashistët e vendit, ku kanë folur duke shpifur me radhë kundër vendeve tona: në fillim Eqrem Telhaj, pastaj kriminelë çekë, rumunë, bullgarë, hungarezë, lituanëzë, polakë etj. Kampet e emigrantëve tradhtarë në Itali: gjendja e tyre është po ajo që e kemi pas një muajve kohë më parë. Nuk ka asnjë ndryshim, me përjashtim që është mbyllur kampi i Banjolit, banorët e të cilit janë shpërndarë nëpër kampet e tjera. Aktiviteti që zhvillojnë ata andej, mund të përmbledhet në dy fjalë: disa bëjnë kontrabandë për të mundur të fitojnë ca para e të përmirësojnë pak gjendjen e jetesës e sidomos të ushqimeve, të cilat janë mizerie, dhe të tjerët ngrohen në diell duke lexuar shtypin e kriminelëve. S.K. Romë 20 maj 1953

(botuar fillimisht në Shqip)

Procedura e punësimit edhe më e thjeshtë

Tashmë për të punësuar colf, badante apo baby-sitter mjafton të ngrini receptorin apo të ndizni kompjuterin. Kjo risi ka ardhur më konvertimin në ligj të dekretit kundër krizës, që ndër masat e thjeshtëzuara për familjet parashikon edhe një për punën shtëpiake. Deri tani ata që punësonin një colf duhej të siguronin një formular të veçantë, ta plotësonin dhe ta paraqitnin në qendrën e punësimit, e cila informonte pastaj Inps-in dhe Inail-in. Një procedurë kjo jo gjithmonë lin-

eare, për shkak të bezdive dhe vonesave e cila u pezullua. Tashmë punëdhënësit duhet t'i komunikojnë drejtpërdrejtë Inps-it, punësimin dhe çfarë-dolloj ndryshimi tjetër të marrëdhënies së punës, pa kaluar më nëpër qendrat e punësimit, e mbi të gjitha pa dalë aspak nga shtëpia: mjafton të telefonohet numri i gjelbër 803.164 apo të lidheni me faqen e internetit www.inps.it. Ndërsa më tradicionalistët mund t'i drejtohen sportelit të Inps-it më të afërt.

Komunikim me telefon apo me internet, por ende nevojitet kontrata e lejeqëndrimit

COLF & BADANTI

Komunikimi duhet bërë të paktën një ditë përpara fillimit të marrëdhënies së punës. Punëdhënësit do të marrin me postë një buletin të paraplotësuar për të paguar kontributet nëpërmjet zyrave postale, kinkalerive (tabaccai) të konvencionuara me bankat. Duke ua ndërlikuar më pak jetën punëdhënësve, mund të sigurohet një mbrojtje më e mirë e të drejtave të punëtorëve dhe të punëtorëve, shpjegon Inps-i në një shënim, duke e përkufizuar këtë risi "një kapit-

ull tjetër në luftën kundër punës së zezë". Sektori shtëpiak nga ana tjetër, është nga më të dëmtuarit nga ekonomia e zezë, me qindra mijëra punëtorë të padukshëm, më së shumti migrues. Por thjeshtëzimi, nuk ka eliminuar kalimin nga i cili për më tepër kërkohet nga ligji për ata që punësojnë shtetas jo komunitarë, pra për dërgimin pranë Sportelit Unik për emigracionin kontratën e lejeqëndrimit të firmosur me punëtorin.

BONUS

PËR FAMILJET edhe kur të afërmit janë në atdhe

Saktësimi i Agjencisë të së Ardhurave. Por duhet të provohet fakti se bëhet fjalë për të afërm në ngarkim

Edhe familjarët e mbetur në atdhe shtojnë numrin e anëtarëve që përfitojnë nga bonoja e familjes. Kështu sqaron një qarkore e Agjencisë së të ardhurave, rreth kontributeve të caktuara nga dekreti kundër krizës, i qeverisë, për më të varfrit.

"Për të përfituar bonon nevojitet që paraqitësi i kërkesës të jetë me banim në Itali" kujton Agjencia. Qarkorja thekson se "për të anëtarët e tjerë të bërthamës familjare të kërkesëbërësit (bashkëshort i pandarë me fëmijë në ngarkim, apo familjarë të tjerë po në ngarkim), në të kundërt nuk nevojitet banimi në territorin italian".

Bonoja mund të kërkohet nga

punësuarit e vartës dhe pensionistët (pra përjashtohen të punësuarit e pavarur, sipërmarrësit e vegjël apo ata që kanë pagesën iva) dhe konsiston në një shumë të ndryshueshme nga 200 deri në 1000 euro sipas të ardhurave të anëtarëve të familjes:

Për të dëshmuar se familjarët e mbetur jashtë shtetit janë në ngarkim duhet të përdoret:

- dokumentet origjinale të lëshuara nga konsullata, me përkthimin në gjuhën italiane dhe noterizim pranë prefekturës;
- dokumentet me apostille, për ata që vijnë nga vende firmuese të Konventës së Hagës në 5 tetor 1961;
- dokumente të lëshuara nga

vendi i vet, të përkthyer italiane dhe të noterizuara konform origjinalit nga konsullata italiane.

Të punësuarit e nënvarur duhet të paraqesin kërkesë pranë punëdhënësit të tyre, punëtorët shtëpiakë (colf, badante, babysutter) pranë sporteleve të Agjencisë së të ardhurave, pensionistët dhe të papunët duket t'i drejtohen Inps-it. Paratë do të mbërrijnë pas një muaji menjëherë me bustapaga (punëdhënësi do të kompensohet nga shteti) apo me pensionin.

Formularët dhe udhëzimet mund të shkarkohen nga faqja e internetit www.agenizientrate.it, por do të ishte mirë t'i drjetohehi një patronati për të

marrë informacione dhe asistencë falas. Ndërkohë afatet për paraqitjen e kërkesës janë zgjatur, të cilat variojnë në bazë të vitit që merret parasysh për të llogaritur të ardhurat dhe anëtarët e familjes.

Punëtorë të varur (kërkesë punëdhënësit) dhe pensionistët (kërkesë Inps-it):

" brenda 28 shkurtit 2009, pra nuk ka më kohë, nëse merret parasysh viti 2007;

" brenda 31 marsit 2009 nëse merret parasysh viti 2008.

Punëtorët shtëpiakë (kërkesë për Agjencinë e të ardhurave):

" brenda 30 prillit 2009, nëse merret parasysh viti 2007;

" brenda 30 qershorit 2009, nëse merret parasysh viti 2008, për ata që nuk janë të detyruar të paraqesin deklaratën e të ardhurave.

" Së bashku me deklaratën e të ardhurave të 2008, për ata që janë të detyruara ta paraqesin nëse merret parasysh viti 2008



Një shtëpi në Tiranë, kushton më pak se një garazh në Romë! Dhe vlera i rritet çdo ditë!



Planimetria e një apartamenti tip dhe lart pamje e simuluar e pallatit. Apartamentet në shitje janë në ndërtim e sipër.

Apartamente banimi në gjelbërimin e parkut të Liqenit, pranë kopshtit botanik të Tiranës.

**Sipërfaqe të ndryshme
Duke filluar nga 800 Euro m2**

K & M Constructions

Tiranë - 069-2080820

Romë - 334-2926786



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek
www.migrart.it



contrasto

WESTERN UNION

IGPDecaux
comunicazione esterna



DEKRETI I FLUKSEVE me 80.000 hyrje

PUNONJËSIT STINORË

Magrini (Coldiretti) "Teksti është gati mungon firma".
Cia: "Shpejtoni kohën"

Janë 80 mijë hyrjet për punëtorët sezonalë jo komunitarë të programuar këtë vit nga qeveria. Dekreti 2009 është teknikisht gati, por nuk

është aprovuar akoma dhe vonesa po vë në pozitë të vështirë bujqësinë.

Janë 80 mijë hyrjet për punëtorët sezonalë jo komunitarë të programuar këtë vit nga qeveria. Dekreti 2009 është teknikisht gati, por nuk është aprovuar akoma dhe vonesa po vë në pozitë të vështirë bujqësinë.

"Teksti është shkruar. Autorizon 80 mijë hyrje aq sa mjaftojnë për të kënaqur kërkesën për krah pune sezonal. Tani nevojitet firma e kryeministrit, pastaj do t'i kalojë Këshillit të lartë të shtetit, dhe në fund do të botohet në Gazetën Zyrtare" sqaron Romano Magrini, përgjegjës për

politikat e punës e Coldiretti.

Punëtorët do të destinohen edhe në sektorin turistik, për sezonin e bareve, hoteleve, dhe restoranteve, por 80 mijë duhet të jenë të mjaftueshëm për të kënaqur kërkesën për punëtorë. Sipas parashikimeve edhe këtë vit, punëdhënësit duhet të paraqesin kërkesë punësimi me internet, vetëm ose duke iu drejtuar shoqatave të kate-

gorive. "Por mund ta bëjnë këtë vetëm pas botimit të dekretit të flukseve, prandaj do të ishte mirë të përshpejtohej praktika ligjore. Të mos harrojmë - thekson Magrini - se më shumë se 50% e krahut të punës në bujqësi vjen nga vendet jo komunitare, dhe sektorë të tëra varen nga punëtorët emigrantë, që nga mbledhja e perimeve dhe e frutave deri tek rritja e kafshëve".

Edhe presidenti i Konfederatës italiane të fermerëve Giuseppe Politi, i ka shkruar ministrit të punëve sociale Maurizio Sacconi duke e nxjerrjen e dekretit.

"Vonesa e nxjerrjes së dekretit është shqetësuese - pohon Politi - sepse programimi i flukseve paraqet një afat skadimi thelbësor për të organizuar veprimtaritë sezonale të sektorit bujqësor, disa prej të cilave janë shumë të afërme", si për shembull mbledhja e luleshtrydheve.

Presidenti i Cia-s njofton se ritmet shumë të ngadalta për ekzaminimin e kërkesave. "Këto vonesa - thotë Politi - sjellin vonesa shumë të gjata pritjeje, duke bërë që të ketë rrezik që punëtorët të mbërrijnë tepër vonë, për veprimtaritë për të cilat janë kërkuar". Pra nëse Nënë Natyra, nuk i përshtatet burokracisë italiane, punëtorët rrezikojnë të mbërrijnë nëpër ara pas mbyljes së sezonit.

Elvio Pasca

BASHKIMET të moshuarve

Duke nisur nga nëntori i kaluar, kanë hyrë në fuqi rregulla më të rrepta në lidhje me bashkimet familjare. Ndër këto njëra parashikon që të moshuarit më të vjetër se 65 vjeç të cilët thirren nga fëmijët e tyre në Itali, duhet të kenë një sigurim shëndetësor apo të regjistrohen pranë Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, duke paguar një kontribut të përkufizuar nga një dekret i ministria e Punës dhe ajo e Ekonomisë. Në të vërtetë ky dekret është ende në diskutim e sipër, dhe për momentin

FAMILJARE

nevojitet sigurimi shëndetësor

Duhet bërë brenda tetë ditësh nga hyrja në Itali. Për momentin është i pamundur regjistrimi pranë Shërbimit shëndetësor kombëtar

është e mundur vetëm pajisja me një sigurim shëndetësor. Kështu sqaron ministria e brendshme, në një qarkore të dërguar pranë gjithë sporteve unike, për imigracionin, i cili përkufizon edhe detaje të tjera të kësaj police të detyruar. Pranoen vetëm sigurime shëndetësore që mbulojnë "rreziqet e sëmundjeve, aksidenteve, dhe mëmësisë (por sa mund të jenë nënat e reja mbi 60 vjeçare? Shënim i redaktorit)". Gjithashtu policat nuk duhet të kenë afat skadimi, "në rast se nuk kërkohet regjistrimi pranë Ssn, duke derdhur edhe një kontribut që do të përcaktohet më pas".

Nga kërkesa për bashkim familjar, deri në hyrjen e prindërve në Itali, kalojnë disa muaj, është e vështirë të dihet me saktësi se sa kohë nevojitet, prandaj nuk është e mundur pajisja me polica para kohe.

Ministria e Brendshme, ka përcaktuar se kur kërkon bashkimin familjar, i biri duhet vetëm të angazhohet për të firmosur policën për prindin. Pastaj kur ky të mbërrijë në Itali, do të ketë e shumta tetë ditë kohë për të firmosur efektivisht policën.

	1	2	3	4	5	6	7		8	9	10	11	12
13		14							15				
16	17		18						19				20
21		22		23			24					25	
26			27			28					29		
30					31						32		
33									35			36	
37			38						39		40		41
			42						43			44	
45									46				

HORIZONTALISHT

1. Luftëtari mysliman, kundërshtues i Kryqëzatave. 8. Shkruajti "Dombi dhe i biri". 14. Funkcion trigonometrik. 15. Zekthi, ish balerin i teatrit të Operës dhe Baletit. 16. Dy të parat e Esterit. 18. Kanxheri, asktor shqiptar. 19. Lumë i Fierit. 20. Simboli kimik i bakrit. 21. Radio Televizioni Italian. 23. Notë muzikore. 24. Një muaj. 25. Selek, aktor. 26. Shteti me Pragën. 28. Masë vëllimi. 29. Futullisti më i madh i të gjithë kohërave. 30. Brokovic, film me Julia Roberts. 31. Barleti i Rrethimit të Shkodrës. 32. Lumë i Londrës. 33. Hyka, personazh i "Përsëri në këmbë". 34. Shuall i këmbës. 35. Në targa të Torinos. 36. Emër vajze. 37. Në targa të Elbasanit. 38. Elvira, e "Yjet nuk vishen kështu". 39. Për Vernin ishin njëzet mijë nën det. 41. Çifte për Asime. 42. Nikolai, shkruajti tregimin "Palltoja". 43. Çmimi për paqen i dhënë Nënë Terezës në 1979. 45. Jeton në Bagdad. 46. Një ishull në Kanarie.

VERTIKALISHT

2. Letër e madhe. 3. Fshat i Pogradecit. 4. Bisha, aktore. 5. Titull i fisnikërisë. 6. Karakteristike e këngeve labe. 7. Simboli kimik i nikelit. 8. Hill, kampion i Formula Uno-s. 9. Lumi që zbret nga Alpet e Francës Juglindore. 10. King pa fund. 12. Veprimi matematik. 13. Dashuria e vërtetë e Edmond Dantesit I. 15. Përzjerja çimento, zhavorr, ujë. 17. Shumë i pastër, pa mikrobe. 19. Dion e këngës (shqip). 20. William, poeti më i madh anglez i shekullit 18. 22. Largohen. 24. Bulba, kozaku. 25. Bëhet objekt studimi në një vepër shkencore. 27. Parafjalë e gjuhës angleze. 28. Cigan; endacak; arixi. 29. Pjesëz mohuese. 31. Lescaut, opera e Puçinit. 32. Gradë ushtarake. 34. Njësia e vogël ushtarake. 35. Santana, ish trajner i Brazilit. 38. Doli pa l me vete. 39. Kloni pa limite. 40. Muhamed, boksieri. 42. Teke në Godo. 43. Jo në gjuhën e Putinit. 44. Njëoftësë në anglisht.

HORIZONTALISHT: 1. SALADINI, 8. DIR-NOBELI 45. IRAKEN, 46. TENERIFE. VERTIKALISHT: 2. AS, 3. LIN, 4. ANILA, 5. DUKA, 6. ISO, 7. NI, 8. DEMON, 9. ISAR, 10. BETON, 11. STERIL, 12. MERCEDES, 13. INS, 22. IKIN, 24. TARAS, 25. TEMA, 27. IN. PEFLE, 30. ERIN, 31. MARIN, 32. TAMIZ, 33. TETOR, 25. TOM, 26. CEKIA, 28. GALON, 29. SEMAN, 20. CU, 21. RTI, 23. LA, 24. ENS, 14. SINUSI, 15. BESIM, 16. ES, 18. NIKO. HORIZONTALISHT: 1. SALADINI, 8. DIR-

1	2	3		4	5	6	7	8	9	10	11		12
13			14										15
16			17				18					19	
		20				21					22		
23	24				25					26			
27				28					29				
30				31					32				33
34			35					36				37	
		38									39		

HORIZONTALISHT

1. Kodër rëre në shkretëtirë. 4. Litar, që i vihet kafshëve. 13. Ngranjëherë, je i shpejtë si ajo. 14. Fi-gurë e Revolucionit Francez. 15. Parafjalë e rasës kallëzore. 16. Gjysma e një mali. 17. Kryeqytet i Perusë. 18. Bob, komedian i TV amerikan, rival i Bing Crosby-t. 19. Nr dy spanjisht. 20. Kryeqyteti mbi shtatë kodra. 21. Ai i madh, kinez i ndërtuar në 1368-1644. 22. Ishte Drakula. 23. Njeri dinak. 25. Markë revolveri (C=K). 26. Në kuzhinë, për të grirë. 27. Lumi më i gjatë i Gadishullit Iberik. 28. Gates i software-t. 29. Personazh i "Zonja nga qyteti". 30. Emër vajze. 31. Asllani, që i ka dhënë emrin stadiumit të lojrave me dorë. 32. Tomas, shkrimtar. 33. Toni pa çifte. 34. Simboli kimik i nikelit. 35. Pons, ishte i Balzakut. 37. Imja, italisht. 38. Republikë në Amerikën Qëndrore me kryeqytet San Jose. 39. Twain "Tom Sojer-it".

VERTIKALISHT

1. Orator i shquar i Greqisë së lashtë. 2. E Kadaresë kishte tri harqe. 3. Simboli kimik i kripës. 4. Gjendje e rëndë shëndetësore mes jetës dhe vdekjes. 5. Është taban pa limite. 6. Fill, përdoret për të qepur. 7. Laget me ujë në të gjitha anët. 8. Është gjimnastika. 9. Lloji, nën-grupi. 10. Çift në një gazete. 11. Tek për një liri. 12. Shkruajti "Doktor Zhivago". 14. Për disa poetë është e lirë. 15. Njësi e rrobaqepësit. 17. Baleti i parë shqiptar. 19. I Qetë për Sholokhovin. 20. Kryeqyteti i Letonisë. 21. Shkruajti "Vejushat gazmore". 22. Qytet veriperëndimor i Gjermanisë. 24. Ishte tradhtar, ai i Trojës. 25. Ajo katolike me qendër në Vatikan. 26. Lumi, që përshkon Dusseldorfën. 28. Skulpturë gjysëmtrup. 29. Venier e TV italian. 31. Jeton në Rusi. 32. Mysafir, i ftuar. 33. Sigël për kamionë. 35. Në targa të Korçës. 36. Rini pa gjysmën. 37. Një rrokje për të thirrur nënën.

VERTIKALISHT: 1. DUNA, 4. MANN, 33. TN, 34. NI, 35. KUSHERIRE. 28. BUST, 29. MARA, 31. RUS, 32. MIR. 33. TIR, 35. KO, 36. RI, 37. MA. VERTIKALISHT: 1. DUNA, 4. KAPITALL, 13. ERA, 14. ROESPPIER, 3. NA, 4. KOMA, 5. ABA, 6. PE, 7. ISHULL. 8. SPORT, 9. TIPI, 10. AEE, 11. LR, 12. PASTERNAK, 14. RIME, 15. POND, 17. LOIA, 19. DONI, 20. RIGA, 21. MOJIER. 22. KEIN, 24. KALI, 25. KISHA, 26. RENDI. 28. BUST, 29. MARA, 31. RUS, 32. MIR. 33. TIR, 35. KO, 36. RI, 37. MA. VERTIKALISHT: 1. DUNA, 4. KAPITALL, 13. ERA, 14. ROESPPIER, 3. NA, 4. KOMA, 5. ABA, 6. PE, 7. ISHULL. 8. SPORT, 9. TIPI, 10. AEE, 11. LR, 12. PASTERNAK, 14. RIME, 15. POND, 17. LOIA, 19. DONI, 20. RIGA, 21. MOJIER. 22. KEIN, 24. KALI, 25. KISHA, 26. RENDI. 28. BUST, 29. MARA, 31. RUS, 32. MIR. 33. TIR, 35. KO, 36. RI, 37. MA.

www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.



Stranieri in Italia



Dashi (21 mars - 20 prill)

Një mik apo familjar do të abuzojë me gadishmërinë tuaj në favorin e vet. Edhe pse do ta kuptoni nuk doni të jepni veten. Në dashuri zgjuarsia juaj dhe vullneti i mirë do t'ju ndihmojnë për të mposhtur një rival. Do të ndjeheni më mirë se kudo darkave me ndonjë shok femëjerie.



Demi (21 prill - 20 maj)

Edhe diçka që e bëni thjesht për zbavitje mund të jetë e dobishme në shumë këndvështrime: do të keni shumë surpriza të këndshme. Duhet hequr dorë nga e shkuara, mund të rifitoni para dhe energji të cilat deri tani i keni shpenzuar kot. Në dashuri mund të ndryshoni sjellje, suksesi do t'ju habisë.



Binjakët (21 maj - 21 qershor)

Është muaj ideal për të shfrytëzuar situatën dhe për të vënë më shumë në dukje prioritetet tuaja të muajve të fundit. Diçka e rëndësishme ka ndryshuar. Pa bërë fjalë të mëdha për një problem të vogël e pa rëndësi, mund të këmbëngulni nëse doni të tregoni pavarësinë tuaj. Më të kujdesshëm në dashuri.



Gaforja (22 qershor - 22 korrik)

Kujdes të mos jeni shumë arrogantë dhe mos t'i jepni shumë mend të tjerëve, për të dalë vetë në dukje. Duhet të tregoheni të qetë dhe të keni besim në forcat e kolegëve. Në jetën private mund t'i kushtoheni asaj që ju intereson, pa dhënë shpjegime. Gjatë marsit jeni të favorizuar në dashuri.



Luani (23 korrik - 23 gusht)

Do të jetë e kotë të mohoni diçka që është bërë mjaft e njohur për të gjithë. Lajmin e mirë që mendonit të mbanit për vetë bëni mië ta festoni me të afërm e miq. Në fushën profesionale bëni mirë të reflektoni për motivet e mbetjes mbrapa dhe të studioni mënyra të reja veprimi.



Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)

Duhet të bindeni njëherë e mirë se nuk ka asgjë më të rëndësishme se sa rritja juaj personale. Duhet të përdorni të gjitha energjitë tuaja për të ndjekur një kurs të rëndësishëm e të domosdoshëm për karrierën. Në familje, po të shpjegoni rëndësinë që i jepni karrierës profesionale do t'ju mirëkuptojnë.



Peshorja (23 shtator - 22 tetor)

Nëse ju mungon dëshira, nuk është e domosdoshme të keni sjellje të njëjtë me njerëz të ndryshëm. Dashuria dhe ndjenjat kërkojnë entuziazëm. Takime të këndshme mes miqsh ju presin mbrëmjeve. Në fushën profesionale po ecni plot energji në një drejtim të ri. Entuziazmi juaj do të përfshijë edhe të tjerët.



Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)

Me ndihmën e Jupiterit do të jeni në gjendje të përfundoni me sukses një detyrë të vështirë, sidomos nëse do të dini të pritni çastin e duhur e të veproni menjëherë. Në dashuri, vendosni nëse doni të filloni një marrëdhënie të re apo të besoni akoma tek një në krizë, sido të veproni, do të jeni të suksesshëm.



Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)

Marsi ju mbështet plotësisht, ndaj mund të merrni në dorë situatën që ju intereson dhe me veprime energjike e të kujdesshme të vini në jetë një plan që deri më sot nuk ju kish dhënë ndonjë rezultat. Në dashuri, nëse keni ndonjë dyshim, shprehjani me sinqeritet partnerit, do t'ju kuptojë e do të ndryshojë.



Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)

Marsi eksitues mund t'ju nxisë për të vepruar me energji e kurajo, por edhe me njëfarë pakujdesie, duke shkaktuar ndonjë keqkuptim. Në sferën sentimentale, për t'iu shmangur mosmarrëveshjeve, lini që të vendosë partneri edhe për ju. Në punë dhe miqësi ka shumë mundësi për përmirësimin e atmosferës.



Ujori (21 janar - 19 shkurt)

Me shumë planetët në shenjë mund të bëni thuajse gjithçka që doni, me kusht që të veproni me kujdes e jo të shtyrë nga intuita e çastit. Në jetën private mund të rindizni dashurinë e partnerit nëse është kjo që dëshironi, në të kundërt, nëse jeni të bindur që marrëdhënia sentimentale po jep shpirt, ndërpriteni.



Peshqit (20 shkurt - 20 mars)

Jeni të dëshpëruar për pritjen e kotë të ndonjë ngjarjeje të rëndësishme që të sjellë të rejtat që dëshironi. Dashurinë lëreni në plan të dytë nëse nuk jeni në qendër të vëmendjes së partnerit. Në profesion mund të aktivizoheni më shumë dhe të mbani nën kontroll të gjithë elementët mbi të cilët keni ndonjë dyshim.

CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA



TANI! KOMISIONE TË REJA NGA ITALIA!

Të afërmit tuaj mund të dërgojnë tani
deri në 100 Euro vetëm me **7 Euro***!

Komisionet janë të vlefshme për dërgesa në Shqipëri nga Lombardia, Emilia Romagna, Piemonte, Liguria, Valle d'Aosta, Trentino Alto Adige, Veneto dhe Friuli Venezia Giulia.

**WESTERN
UNION** | |[®]

Përveç komisionit të transfertës Western Union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhën vendase. Komisionet janë të vlefshme për një periudhë të pa përcaktuar duke filluar nga 28 Janar 2008.

**Transfertë parash - e shpejtë, e besueshme.
Për më shumë informacion: +355 4 23 49 79**